

GJYKATA E QARKUT NË PEJË
LËNDA Nr.112/10
15 Tetor 2010

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Pejë, me trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Malcolm Simmons si Kryetar i Trupit Gjykues dhe Gjyqtarët Verginia Micheva-Ruseva dhe Lumturije Muhaxheri si anëtarë të trupit gjykues dhe Robina Struthers si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër Danil Nokaj (i Pandehuri), i akuzuar sipas aktakuzës PP.numër 340/2005, datë 25 gusht 2008 me dy akuza për vrasje të kryera për gjakmarrje dhe në mënyrë mizore dhe të fshehtë nga neni 30 (2) pika 1 dhe 4 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës të vitit 1977 (tani KPK) lidhur me nenin 22 të Ligjit Penal të Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë (LPRFSJ), që ndëshkohet sipas nenit 30 (3 e LPK, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 12, 20 korrik 2010 dhe 2 shtator 2010, 3 shtator 2010, 7, 8, 28, 30 shtator 2010 dhe 12 tetor 2010 në të cilin Z. Ali Uka është paraqitur për Prokurorinë, Z. Zenel Mekaj dhe Z. Haxhi Cekaj për të pandehurin dhe Z. Haxhi Millaku për palën e dëmtuar dhe të cilin ish-in të pranishëm i pandehuri dhe pala e dëmtuar Luz Allakaj, me datë 15 tetor 2010 mori dhe shpalli publikisht si në vijim

AKTGJYKIM

I pandehuri Danil Nokaj, lindur me datë 12 prill 1970 në fshatin Marmullë, Komuna e Gjakovës, mashkull, emri i babait Nikolla, emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës Prenë Gojani, shqiptar kosovar, me vendbanim në fshatin Marmullë, ka kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, baba i 5 fëmijëve, gjendje ekonomike mesatare, i padënuar më parë, në paraburgim në Kosovë prej datës 29 maj 2008 shpallet

FAKTOR

Sepse

1. Me datë 19 mars 2004, rreth ores 10.30 në fshatin Marmullë, Komuna e Gjakovës, tek ura e Jakës, si bashkëkryes, më dashje dhe në mënyrë brutale ka vrrarë Dedë Allakaj si hakmarrje për vrasjen e Engjëll Nokaj nga Anton Allakaj, djali i Dedë Allakaj në korrik të vitit 2000, bashkë me Anton Nokaj dhe Simon Nokaj si dhe persona të tjerë për momentin të panjohur apo në arrati, të armatosur me armë automatike, kanë ngritur pritë Dedë Allakajt i cili udhëtonte në një veturë Mercedes me targa 119 KS 154 bashkë me vëllain e tij Tunë Allakaj dhe kanë qëlluar pa dallim në makinën në fjalë dhe si rezultat i kësaj Dedë Allakaj është qëlluar nga disa plumba të cilët kanë shkaktuar shqyerjen e organeve vitale përfshirë trurin, trakean dhe enët e gjakut të qafës duke rezultuar në vdekjen e tij në vend dhe pastaj ata kanë ikur nga vendngjarja me një veturë Opel Vectra me targa 408 KS 799 që vozitej nga i pandehuri;

2. Me datë 19 mars 2004 rreth ores 10.30 në fshatin Marmullë, Komuna e Gjakovës, tek ura e Jakës, si bashkëkryes, më dashje dhe në mënyrë brutale ka vrrarë Dedë Allakaj si hakmarrje për vrasjen e Engjëll Nokaj nga Anton Allakaj, djali i Dedë Allakaj në korrik të vitit 2000, bashkë me Anton Nokaj dhe Simon Nokaj si dhe persona të tjerë për momentin të panjohur apo në arrati, të armatosur me armë automatike, kanë ngritur pritë Tunë Allakajt i cili udhëtonte në një veturë Mercedes me targa 119 KS 154 bashkë me vëllain e tij Dedë Allakaj dhe kanë qëlluar pa dallim në makinën në fjalë dhe si rezultat i kësaj Tunë Allakaj është qëlluar nga disa plumba të cilët kanë shkaktuar shqyerjen e arteries së karotidës së majtë dhe pastaj ata kanë ikur nga vendngjarja me një veturë Opel Vectra me targa 408 KS 799 që vozitej nga i pandehuri. Si rezultat i plagëve të marra gjatë sulmit, Tunë Allakaj ka pasur një shok hemoragjik që ka rezultuar në vdekjen e tij gjatë rrugës për në spitalin e Prishtinës;

PËR KËTË ARSYE, nën akuzat e mësipërme 1 dhe 2, si bashkëkryes, i pandehuri ka kryer veprën penale të vrasjes të kryer për gjakmarrje dhe në një mënyrë brutale sipas nenit 30 (2) pika 1 dhe 4 i LPK lidhur me nenin 22 të LPRFSJ që ndëshkohet sipas nenit 30 (3) të LPK dhe

DËNOHET

Me burgim afatgjatë 25 (njëzet e pesë) vjet.

Sipas nenit 73 të Kodit Penal të Kosovës, në dënimin me burg llogaritet koha që i pandehuri ka kaluar në paraburgim në Zvicër nga data 10 korrik 2007 deri me 28 maj 2008 kur i pandehuri është ekstraduar në Kosovë dhe paraburgimi i tij në Kosovë prej datës 28 maj 2008 e tutje.

Në pajtim me nënin 102 (2) të Kodit të Procedurës Penale (KPPK) i pandehuri do të paguajë shpenzimet e kësaj procedure penale në shumën prej 500 (pesëqind) euro. Gjithashtu i pandehuri do të paguajë shumën prej 100 euro në emer te paushallit gjyqsor.

Në pajtim me nenin 393 (5) të KPPK i pandehuri do të qëndrojë në paraburgim deri në momentin kur ky aktgjykim bëhet i plotfuqishëm.

Në bazë të nenit 112 (2) të KPPK pala e dëmtuar mund të parashtrojë kërkesë për kompensim në procedurë civile.

Në pajtim me nenin 391 (1) (6) të KPPK, aktgjykimi i plotfuqishëm mund të shpallet në media publike.

ARSYETIMI

Aktakuza PP. numër 340/2005 është e datës 25 gusht 2008.

I pandehuri është ngarkuar me dy akuza për vrasje, nga neni 30 (2) pikat 1 dhe 4 të LPK, lidhur me nenin 22 të LPRFSJ, të Tunë Allakaj dhe Dedë Allakaj, të kryera tek Ura e Jakës, në fshatin Marmullë, Komuna e Gjakovës me datë 19 mars 2004. Në veçanti, i pandehuri, në bashkëveprim me Simon Nokaj, Anton Nokaj dhe Rrok Bezhi, të armatosur me armë automatike të kalibrit 7.62 mm, të llojit të panjohur, kanë ngritur pritë Tunë Allakajt dhe Dedë Allakajt afër urës së Jakës. Grupi ka qëlluar nga një distancë prej prej 4-5 metra disa rafale nga armë zjarri duke qëlluar Tunë Allakaj dhe Dedë Allakaj me shumë plumba në pjesë të ndryshme të trupave të tyre duke shkaktuar plagë që kanë shkaktuar vdekjen e tyre. Vrasja është kryer në kuadrin e një hakmarrje e filluar nga djali i të ndjerit Dedë

Allakaj, Antoni, i cili ka vrarë të ndjerin Engjell Nokaj, një i afërm i të pandehurit. Për këto vepra parashihet një dënim prej nga dhjetë deri në katërdhjetë vjet burgim.

Aktakuza është konfirmuar me datë 17 tetor 2008.

Shqyrtimi kryesor i parë është mbajtur mes datës 21 prill dhe 11 qershor 2009.

Me datë 11 qershor 2009, i pandehuri është shpallur fajtor për dy akuza për vrasje "të kryera si hakmarrje dhe në mënyrë brutale dhe tinzare". I pandehuri është dënuar me 20 vjet burgim për secilën akuzë me një dënim të unifikuar prej 33 vitesh.

Me datë 6 prill 2010 Gjykata Supreme e Kosovës ka anuluar aktgjykimin e shkallës së parë dhe e ka kthyer lëndën për rigjykim.

Veprat penale janë kryer para hyrjes në fuqi të Kodit të Penal të Kosovës (KPK) me datë 6 prill 2004.

Neni 2 (1) dhe (2) i KPK parasheh se aplikohet ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale përveç rastit kur ligji i mëvonshëm është më i favorshëm për të pandehurin.

Neni 147 (3) i KPK parasheh një dënim me të paktën 10 vjet apo dënim afatgjatë për të pandehurit që janë shpallur fajtorë për vrasje të kryer në mënyrë mizore dhe mashtruese. E njëjta gjë aplikohet nën nënparagrafin (9) për ata që shpallen fajtorë për vrasje të kryer për hakmarrje të paskrupullt apo motiv tjetër të ulët.

Neni 37 (2) i KPK parasheh se dënimi afatgjatë shqiptohet në kohezgjatje prej 21 deri në 40 vjet burgim.

Dënimi me vdekje është hequr¹ dhe zëvendësuar me dënim afatgjatë deri në 40 vjet.

Neni 30 (2) i LPK që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale parasheh dënim me të paktën 10 vjet burgim apo dënim me vdekje për ata që shpallen fajtorë për vrasje të kryer në mënyrë brutale apo tinzare apo si rezultat i hakmarrjes.

¹ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 dhe 2000/59.

Veprat penale të ngritura më aktakuzë përmbajnë burgim afatgjatë me nga 10 deri në 40 vjet bazuar në ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale dhe në ligjin e mëvonshëm. Meqënëse ligji i ri nuk është më i favorshëm për të pandehurin, Gjykata ka aplikuar ligjin në fuqi në kohën e kryerjes së veprave penale.

Gjykata ka dëgjuar dëshminë e Luz Allakaj, Gjon Nikolles, Vilson Nikolles, Gjin Preqit, Mhill Berishes dhe të pandehurinin.

Lidhur me deklaratat dhe/apo dëshmitë e mëparshme të **dëshmitarëve në vijim** është gjetur pajtim duke shmangur kështu nevojën për ti thirrur ata përsëri:

- Anton Nikolla : Dëshmi e dhënë me datë 6 maj 2009 në gjykimin e parë, deklarata e dhënë në polici me datë 19 mars 2004, deklarata e dhënë në prokurori në lëndën Danil Nokaj me datë 31 korrik 2008, Dëshmia e dhënë në gjykimin kundër Anton Nokaj me datë 2 mars 2005, siç është rënë në pajtim gjatë seancës në gjykim të datës 12 korrik 2010 dhe deklarata e dhënë para prokurorit në lëndën kundër Anton Nokaj dhe të tjerë me datë 6 prill 2004 siç është pajtuar gjatë seancës së gjykimit me datë 28 shtator 2010;
- Zef Delija : Dëshmia në gjykimin e Anton Nokaj me datë 6 prill 2005 siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit të datës 12 korrik 2010;
- Robert Delija : Deklarata e dhënë në polici me datë 8 mars 2004, deklarata e dhënë para Prokurorit me datë 29 prill 2004, Dëshmia në gjykimin kundër Anton Nokaj me datë 5 prill 2005, siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;
- Pren Hili : Dëshmia e datës 13 maj 2009 në gjykimin e parë kundër të pandehurit, Dekalarata e dhënë para prokurorit në lëndën Simon Nokaj me datë 21 tetor 2005, siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 30 shtator 2010;
- Biter Prekaj: Dëshmia e datës 18 maj 2009 në gjykimin e parë kundër të pandehurit siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;

- Anton Marku : Dëshmia e dhënë në gjykimin Anton Nokaj me datë 17 mars 2005 siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;
- Mentor Bytyqi: Dëshmia e datës 14 maj 2009 në gjykimin e parë, dëshmia në gjykimin kundër Anton Nokaj me datë 31 mars 2005 siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;
- Gjok Komani: Dëshmia e datës 14 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit, deklarata e dhën para prokurorit në lëndën kundër Anton Nokaj dhe të tjerë me datë 27 prill 2004, Dëshmia në gjykimin e Anton Nokaj me datë 5 prill 2005 siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;
- Prene Nokaj: Dëshmia e datës 12 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;
- Trashe Nokaj : Dëshmia e datës 12 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010;
- Alfred Nokaj: Dëshmia e datës 13 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit siç u pajtua gjatë seancës së gjykimit me datë 12 korrik 2010.

Deklarata e mëparshme e Mikel Berishës e datës 4 gusht 2008 është futur në prova sipas nenit 368 të KPPK përmes një vendimi të marrë me datë 30 shtator 2010.

U pajtua lidhur me vendimin i Prokurorit Publik që urdhëron matjen e thirrjeve telefonike të bëra nga Gjin Preqi, datë 19 mars 2004 dhe shënimet e matjeve/raporti i policisë.

U pajtua lidhur me raportin e vendngjarjes 2004 DB 810 i përpiluar nga Njësia e Forensikës në Gjakovë me datë 24 mars 2004.

U pajtua lidhur me fotografitë e veturës Opel Vectra me targa 408-KS-799.

U pajtua lidhur me raportin e ekzaminimit të veturës Mercedes me targa 119 KS 154 i datës 23 prill 2004.

U pajtua lidhur me fotografitë e veturës Mercedes me targa 119 KS 154.

U pajtua lidhur me vendngjarjen HNP numër 30/04 datë 19 mars 2004.

U pajtua lidhur me raportin e ballistikës B040258 datë 14 maj 2004 të Qlirim Hajdinit.

U pajtua lidhur me dëshminë e Qlirim Hajdinit të datës 18 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit.

U pajtua lidhur me raportin e autopsisë (Tune Allakaj) numër MA 04/065 i qershorit të vitit 2004 përpiluar nga Asim Gerxhaliu.

U pajtua lidhur me raportin e autopsisë (Dede Allakaj) numër MA 04/064, maj 2004 përpiluar nga Asim Gerxhaliu.

U pajtua lidhur me dëshminë e Arsim Gerxhaliut e datës 18 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit.

U pajtua lidhur me dëshminë e Arsim Gerxhaliut e datës 30 mars 2005.

Provat për të cilat palët janë pajtuar janë futur në procesverbal si të lexuara.

Gjykata ka futur në prova një fotografi² ajrore të vendit.

Trupi Gjykues ka bërë një shiqim të vendngjarjes në vend me datë 8 shtator 2010 bazuar në një urdhër të gjykatës të datës 19 gusht 2010.

Me datë 19 mars 2004 Dede Allakaj dhe Tune Allakaj janë qëlluar me armë automatike ndërsa ishin duke vozitur në një veturë Mercedes me targa 119 KS 154 në drejtim të Urës së Jakës ("Ura") në fshatin Marmullë, komuna e Gjakovës.

Me datë 6 maj 2005, Anton Nokaj është shpallur fajtor për vrasjen e Dede Allakaj dhe Tune Allakaj dhe kjo është vertetuar pjesërisht nga aktgjykimi i Gjykatës Supreme i datës 19 maj 2006 i cili ka ndryshuar vetëm dënimin. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është vertetuar edhe më tej

² Prova C1

nga aktgjykim i Gjykatës Supreme i datës 26 shtator 2007 mbi mbrojtjen e ligjshmërisë.

Gjithashtu me datë 19 shkurt 2007 Simon Nokaj është shpallur fajtor, si bashkëkryes i vrasjeve të Dede Allakaj dhe Tune Allakaj.

Anton Nokaj deklaroi veten fajtor për vrasjet e Dede dhe Tune Allakaj. Ai ka deklaruar se ka vepruar vetëm.

Një njësi hetimore nga policia e Gjakovës ka shkuar në vendngjarje në orën 11:30 ditën në fjalë dhe ka bërë një vlerësim fillestar. Vetura Mercedes D300 me targa 119 KS 154 kishte qëndruar në vend. Trupi i Dedë Allakaj ishte në ulësen e pasqerit përpara.

Gjatë ekzaminimit të vendngjarjes policia ka gjetur 19 gëzhoja bosh dhe dy fishekë në vendngjarje (të kalibrit 7.62 x 39). Gëzhojat janë gjetur afër veturës, njëra prej tyre menjëherë poshtë pjesës së përparme të veturës dhe të tjerat në distance të ndryshme në rrugë apo në anën e djathtë të rrugës pas veturës.

Policia ka konfiskuar edhe 16 gëzhoja të kalibrit (7.62 x 39) në apo afër shtëpisë së Anton Nokaj.

Mercedesi është ekzaminuar më tej nga policia me datë 22 prill 2004. Janë evidentuar vrimat e plumbave si në vijim:

- Pesë vrima plumbash në xhamin e përparmë;
- Gjashtë vrima plumbash në xhamin e pasëm;
- Të katër dritaret anash ishin të thyera dhe në ulëse kishte shpime dhe shenja gërvishtje;
- Në kapakun që mbulon motorrin gjendej një vrimë plumbi shkaktuar nga një armë që ka shtënë nga përpara;
- Një vrimë plumbi në anën e djathtë, mes gomës përpara dhe derës përpara, shtënë nga një kënd i tërthortë nga lart poshtë;
- Një vrimë plumbi në pasqyrë, shkaktuar nga një armë që ka shtënë nga ana përpara veturës;

- Dy vrima plumbash në derën përpara në anën djathtë, shkaktuar nga të shtëna armësh nga ana e djathtë;
- Pesë vrima plumbash në derën e pasme në anën e djathtë shkaktuar nga të shtëna armësh nga ana e djathtë, nga pas përpara;
- Një vrimë plumbi afër kapakut të serbatorit shkaktuar nga një armë që ka shtënë nga ana e djathtë;
- Një vrimë plumbi në pjesën e pasme të djathtë të veturës, shkaktuar nga një armë që ka shtënë nga pjesa e pasme;
- Një vrimë plumbi në gomën prapa në anën e djathtë;
- Një vrimë dalëse në derën e pasme në anën e majtë;
- Vrima plumbash në pjesën e sipërme të ulëses përpara në anën e pasqerit, në mbështetësen e kokës.

Në shasinë e Mercedesit janë gjetur 24 vrima plumbash.

Përveç gëzhgjës të gjetur në pjesën e përparme të veturës, të tjerat janë gjetur pas veturës në një distancë nga 6 dhe 28 metra.

Luz Allakaj ka dëshmuar në gjykimin e parë me datë 5 maj 2009. Ai ka dhënë deklaratë përpara prokurorit me datë 14 prill 2004 dhe në korrik 2008. Ai ka dëshmuar në gjykimin kundër Anton Nokaj me datë 1 mars 2005 dhe 12 prill 2005.

Me datë 19 mars 2004 Luz Allakaj ka qenë në shtëpi me vëllezërit e tij Tunë dhe Dede Allakaj.

Rreth orës 10.30 Tune Allakaj dhe Dede Allakaj janë larguar nga shtëpia me një Mercedes D300 me targa 119 KS 154 që vozitej nga Tune Allakaj.

Pak kohë pasi që Tune Allakaj dhe Dede Allakaj janë larguar nga shtëpia Luz Allakaj është informuar nga Robert Allakaj dhe Gjergj Allakaj se ata kishin dëgjuar të shtëna nga drejtimi i Urës.

Luz Allakaj ka përshkruar se ka qenë i shqetësuar për vëllezërit duke pasur parasysh konfliktin e vazhdueshëm me familjen Nokaj.

Ai voziti me makinën e tij Volkswagen Passat në drejtim të urës. Ai ishte së bashku me Robert Allakajn dhe Gjergj Allakajn. Kjo përputhet me dëshminë që ka dhënë më parë përpara Gjykatësit Hetues më datë 14 prill 2004. Avokati i të Pandehurit e ka sfiduar këtë dëshmi duke thënë se kur është marrë në pyetje më datë 25 nëntor 2005 ai ka deklaruar se ka qenë vetëm bashkë me Robert Allakajn. Kjo mospërputhje nuk ishte relevante për faktet konkrete.

Gjatë rrugës për tek Ura, Luz Allakaj kishte takuar Anton Nikollën. Luz Allakaj ka dëshmuar se Anton Nikolla i kishte thënë atij "Shko shpejt, kanë qëlluar Tunën". Me sa duket, Dede Allakaj nuk ishte përmendur. Kjo dëshmi përputhet me atë që Luz Allakaj ka dëshmuar më parë para Gjykatësit Hetues në prill 2004. Kur ai dëshmoi gjatë shqyrtimit të parë ai tha se Anton Nikolla kishte thënë "Shko shpejt, vëllezërit t tu janë qëlluar".

Ai dëshmoi se nuk i kujtohej nëse Anton Nikolla kishte përmendur se nga kush ishte qëlluar Tuna. Kjo nuk përputhej me dëshminë që ai ka dhënë gjatë shqyrtimit të parë kundër të Pandehurit kur ai tha se Anton Nikolla kishte thënë se të shtënat ishin qëlluar nga "Nokajt". Kur ai dëshmoi përpara Gjykatësit Hetues në prill 2004, Luz Allakaj iu referua takimit të tij me Anton Nikollën dhe tha se Anton Nikolla i kishte thënë atij "ata qëlluan Tunën". Në atë deklaratë thuhet se vetëm kur ai ishte jashtë dyqanit njerëzit i thanë se ishte "Nokaj".

Luz Allakaj dëshmoi se ai vazhdoi të voziste në drejtim të Urës. Gjatë rrugës kaloi gjatë dyqanit të Zef Mark Delisë (pas kësaj "dyqani"). Kur ai arriti tek dyqani³, ai vërejti afërsisht pesëmbëdhjetë - njëzet persona që po qëndronin jashtë. Ai i pyeti se çfarë kishte ndodhur. Dikush, nuk i kujtohej se kush, kishte thënë "Shko shpejt, kanë qëlluar vëllezërit e tu"

Luz Allakaj dëshmoi se disa nga personat e pranishëm kishin thënë se vëllezërit e tij ishin qëlluar nga "Nokajt". Ai tha se nuk i kujtohej se kush e kishte thënë këtë. Kur dëshmoi gjatë shqyrtimit të parë të të Pandehurit ai ia

³ Numër 3 Dëshmia C1

atribuoi këtë koment Vilson Nikollës i cili kishte thënë "shko shpejt sepse ata kanë vrarë vëllezërit e tu" dhe në përgjigje të pyetjes "Kush ishin ata?" Vilson Nikolla ishte përgjigjur "Nokajt". Në deklaratën e tij dhënë më datë 14 prill 2004 e vetmja bisedë, të cilës ai i referohet që ka patur me personat jashtë dyqanit, ishte ajo që dikush i kishte thënë "Kanë qëlluar Tunën" dhe përgjigja e pyetjes së tij ishte "Nokajt". Në dëshminë e tij dhënë më datë 1 mars 2005, kur u pyet se kush, nga personat jashtë dyqanit, i kishte identifikuar personat që kishin qëlluar si "Nokajt" ai ishte përgjigjur "Mendoj se ishte Vilson Nikolla".

Luz Allakaj dëshmoi se ai kishte arritur në vendngjarje⁴ 7 - 8 minuta pasi ishte nisur nga shtëpia. Kur dëshmoi gjatë gjykimit të parë ai mendonte se në vendngjarje kishte arritur afërsisht 10 - 15 minuta pasi ishin dëgjuar të shtënat por kur ishte marrë në pyetje më tej nga pala tjetër ai tha se deri tek dyqani ishte njëzet minuta dhe një minutë tjetër deri në vendngjarje. Gjon Nikolla, Vilson Nikolla, Anton Nikollla, Gjok Berisha dhe Peter Oroshi kishin arritur në vendngjarje shpejt pas Luz Allakajt.

Kur kishte arritur në vendngjarje Luz Allakaj kishte parë Mercedesin e vëllezërve të tij të ndaluar në mes të rrugës. Motorri i Mercedesit nuk ishte i ndezur. Ai menjëherë vuri re në makinë, ato të cilat dolën të ishin, vrima plumbi. Rreth e qark makinës ai kishte parë gëzhoja në tokë. Tune Allakaj dhe Dede Allakaj ishin akoma brenda në makinë. Tune Allakaj ishte i ulur në ulësen e vozitësit dhe Dede Allakaj parapara, në ulësen e pasagjerit. Dede Allakaj kishte vdekur. Tunë Allakaj ishte akoma gjallë.

Luz Allakaj përshkroi hapjen e derës së makinës. Ai dëshmoi përpara kësaj Gjykate se ai kishte pyetur Tunën "Kush e bëri këtë ". Tune ishte përgjigjur "Nokajt".

Në deklaratën e tij të datës 14 prill 2004 ai tha se Gjon Nikolla kishte arritur në vendngjarje dhe se e kishte ndihmuar që t'a lëviznin Tunën në ulësen prapa të makinës.

Kjo përputhet me dëshminë e tij të datës 14 prill 2004, 31 korrik 2008 dhe 5 maj 2009, 1 mars 2005 dhe 12 prill 2005.

⁴ Prova C1 numër 5

Luz Allakaj dëshmoi se Tuna arriti të dalë jashtë makinës dhe të futej në makinë në pjesën prapa nëpërmjet derës së pasme të makinës.

Luz Allakaj dëshmoi se ai i kishte thënë Gjon Nikollës që të voziste Mercedesin në spital. Gjon Nikolla ishte ulur në ulësen e vozitësit dhe ishte përpjekur që të ndizte makinën.

Luz Allakaj dëshmoi se ai përsëri kishte pyetur Tune Allakajn kush ishte përgjegjës. Tune Allakaj : "Nokajt. Danili, Antoni, Simoni, Leonardit dhe Rrok Bezhi"

Kjo dëshmi përputhet me dëshminë që ai ka dhënë përpara Gjykatësit Hetues në prill 2004.

Kur dëshmoi gjatë gjykimit të parë Luz Allakaj tha se në përgjigje të pyetjes së tij Tune ishte përgjegjës "Nokajt". Më pas, kur ishin në ulëset mbrapa makinës Luz Allakaj deklaroi se ai kishte pyetur përsëri dhe se kishte marrë përgjigjen "Danil Nokaj, Anton Nokaj, Rrok Bezhi, Leonard Nokaj dhe Simon Nokaj". Dhe vërtet, kur iu përgjigj një pyetje të shtruar nga Kryetari i Trupit Gjykses, Luz Allakaj dëshmoi "[Tune]...përmendi emrat dhe mbiemrat". Dëshmia e dhënë gjatë gjykimit të parë përputhet me dëshminë e tij dhënë më datë 31 korrik 2008 dhe 1 mars 2005.

Luz Allakaj dëshmoi se, gjatë këtij shkëmbimi, Tune Allakaj kishte thënë se i Pandehuri ishte "përpara". Tune Allakaj me sa duket nuk kishte përmendur pozicionin e personave të tjerë të cilëve iu ishte referuar.

Kur Luz Allakaj dëshmoi para Gjykatësit Hetues më datë 14 prill 2004 ai, mes të tjerash, deklaroi, "Unë isha ulur në krah të Tunës dhe e pyeta atë përsëri se çfarë kishte ndodhur. Edhe njëherë ai tha 'Nokajt, Danili, Antoni, Simoni, Leonardit dhe Rrok Bezhi. Danili ishte personi përpara.'" "

Luz Allakaj u mor në pyetje nga avokati mbrojtës i të Pandehurit në lidhje me faktin se ai kishte dështuar, që në raste të tjera, të përmendte faktin se Tune Allakaj kishte theksuar se i Pandehuri ishte "...personi përpara". Luz Allakaj dëshmoi duke i përgjigjur se kjo ishte kështu thjesht sepse nuk ishte pyetur për këtë.

Kur ai dëshmoi më datë 14 prill 2004 ai tha se Tuna kishte folur me pak vështirësi. Është e qartë nga raporti post mortem dhe nga dëshmia dhënë nga Doktor Arsim Gerxhalliu me datë 30 mars 2005, të cilës do t' i referohet këtu, se Tuna kishte pësuar, mes të tjerash, lëndime në faqen e djathtë dhe në gjuhë.

Duke mos mundur që të ndezë Mercedesin, Tuna ka dalë nga vetura dhe ka hyrë në veturën e Luz Allakaj, Volkswagen Passat, në pjesën prapa. Vilson Nikolla ka vozitur Passatin për në spital në Gjakovë. Ai shoqërohej në veturë nga Anton Nikolla.

Luz Allakaj ka vozitur veturën e Anton Nikollas për në spital.

Pas arritjes në spital Luz Allakaj ka dëshmuar lidhur me një bisedë tjetër të shkurtë me Tune Allakaj gjatë së cilës ai ka pyetur Tunën "Personat që më përmende, a e kanë bërë ata këtë". Tune Allakaj është përgjigjur duke pohuar me kokë. Kjo është në përputhje me deklaratat e tij të datës 14 prill 2004 dhe 31 korrik 2008.

Gjon Nikolla ka dëshmuar në gjykimin e parë me datë 5 maj 2009. Ai ka dhënë deklaratat Prokurorit me datë 26 prill 2004, 25 nëntor 2005 dhe është intervistuar nga Prokurori me datë 31 korrik 2008. Ai ka dëshmuar në gjykimin kundër Anton Nokaj me datë 3 mars 2005.

Ai ka njohur të pandehurin që nga fëmijëria. Ata ishin bashkëfshatarë. Ai ka përshkruar marrëdhënien e tij me palën e dëmtuar si të mirë. Ai kishte dijeni për një gjakmarrje mes familjes Nokaj dhe familjes Allakaj si rezultat i vdekjes së Engjell Nokaj.

Ditën në fjalë Gjon Nikolla ka qenë në ballkonin e katit të parë të shtëpisë së tij kur ai ka parë një Mercedes D300 që shkonte drejt Urës. Ai ka dëshmuar se portat e pronës së tij ishin të hapura dhe se ai kishte një pamje të qartë të rrugës. Ai ka njohur veturën dhe se ajo ishte pronë e familjes Allakaj.

Rreth orës 10.30am ai ka dëgjuar të shtëna armësh. Ai ka dëshmuar se nuk ka mundur të përcaktojë nëse të shtënat ishin të një arme automatike. Zhurma e shtënave me armë ka ardhur nga drejtimi i Urës.

Ai është veshur dhe ka hyrë në veturën e tij. Luz Allakaj ka kaluar aty duke vozitur veturën e tij. Gjon Nikolla ka bërë me dorë Luz Allakajt, duke bërë shenjë se ai duhej të shkonte në drejtim të Urës. Kjo është në përputhje me dëshminë që ai ka dhënë me datë 3 mars 2005 dhe 5 maj 2009.

Ai ka vozitur veturën e tij në drejtim të Urës.

Gjatë rrugës për tek Ura ai ka kaluar nga dyqani. Kur ai i afrohej dyqanit ai ka parë persona që qëndronin jashtë. Atij nuk i kujtohej të ketë folur me ndonjë person gjatë rrugës për tek Ura. Në dëshminë e tij me datë 3 mars 2005 ai ka thënë se Vislon Nikolla kishte thënë se kishte ndodhur diçka Tunës dhe Dedës.

Kur ka arritur ai është afruar veturës së të ndjerëve nga ana e djathtë. Luz Allakaj është afruar veturës nga ana e majtë.

Gjon Nikolla ka dëshmuar se dukej se Dede Allakaj ishte i vdekur. Pastaj ai ka shkuar në anën e majtë të veturës. Tuna ishte i vetëdijshëm.

Ai ka dëshmuar se Luz Allakaj ka thënë Tunës "kush ishte vëlla?" Tuna është përgjigjur "Nokajt". Në deklaratën e tij të datës 26 prill 2004 ai ka deklaruar se Luz Allakaj ka pyetur Tunën "vëlla, a je gjallë?". Në atë deklaratë ai nuk ka përmendur ndonjë shkëmbim tjetër mes Luz Allakaj dhe Tunës përpara se Tuna të vendosej në ulësen prapa të Mercedesit. Megjithatë, kjo është në përputhje me deklaratën që ai ka dhënë me datë 3 mars dhe 25 nëntor 2005 dhe me dëshminë e tij të datës 5 maj 2009.

Gjon Nikolla ka dëshmuar se Tuna ka mundur të ecë për në pjesën e pasme të Mercedesit ku është ulur në ulësen prapa. Ai është ulur në ulësen pas vozitësit. Gjon Nikolla është përpjekur të ndezë veturën.

Gjon Nikolla ka dëshmuar se Luz Allakaj e ka pyetur Tunën përsëri se kush ishte përgjegjës.

Gjon Nikolla ka dëshmuar se Tuna është përgjigjur "Antoni, Danili, Rroku, Simoni dhe Leonardi. Kjo është në përputhje me deklaratën e tij të datës 26 prill 2004, dëshminë e tij të datës 3 mars 2005, deklaratën e tij të datës 25 nëntor 2005 dhe dëshminë e tij të datës 5 maj 2009. Gjon Nikolla ka thënë se Tuna nuk ka përmendur më të pandehurin.

Gjon Nikolla ka dëshmuar se ai ka dëgjuar emrat qartë. Kjo është në përputhje me deklaratën që ai ka dhënë përpara gjyqtarit hetues me datë 26 prill 2004. Në këtë deklaratë ai ka thënë se Tuna ka folur me vështirësi. Kjo është gjithashtu në përputhje me deklaratën e dhënë me datë 25 nëntor 2005 dhe dëshminë e tij të dhënë me datë 5 maj 2009.

Në deklaratat e tija të datës 31 korrik 2008 Gjon Nikolla ka thënë se ai ka dëgjuar Tunën të thotë "Danil Nokaj, Rrok Bezhi, Simon Nokaj, Anton Nokaj dhe Leonard Nokaj". Kjo është në përputhje me deklaratën e tij të datës 26 prill 2004.

Duke mos mundur të ndezë Mercedesin, Tuna është transferuar në Volkswagen Passat të Luz Allakajt. Ajo veturë është vozitur për në spital në Gjakovë nga Anton Nikolla. Ai shoqërohej në veturë nga Vilson Nikolla.

Gjon Nikolla ka vozitur deri në Gjakovë me Luz Allakaj. Ai ka dëshmuar së më vonë Gjin Preqi u ka ofruar atyre që ti vozisë deri në Prishtinë sepse ata nuk kishin veturë. Pastaj ai ka ndjekur ambulancën deri në Prishtinë. Ai është kthyer në Marmullë me Luz Allakajn, Gjin Preqin dhe Sokol Preqin.

Vilson Nikolla ka dëshmuar në gjykimin e parë me datë 5 dhe 6 maj 2009. Ai është intervistuar nga Prokurori me datë 25 shkurt 2005 dhe 31 korrik 2008. Ai ka dëshmuar në gjykimin kundër Anton Nokaj me datë 31 mars 2005.

Vilson Nikolla banon në shtëpinë⁵ përballë dyqanit të Zef Delisë⁶.

Vilson Nikolla është i verbër në syrin e majtë dhe ishte kështu në kohën në fjalë. Ai ka dëshmuar se pamja e tij në syrin e djathtë- larg dhe afër - është e mirë. Ai tha se nuk mban syze.

Ai ka dëshmuar se ditën në fjalë rreth orës 7.30 ai ishte në dhomën e fjetjes në katin e dytë të shtëpisë së tij kur ai ka parë Opel Vectrën ngjyrë blu të errët të familjes Nokaj të ndalur përpara shtëpisë së Rrok Bezhit⁷.

⁵ Prova C1 numër 7

⁶ Prova C1 numër 3

⁷ Prova C1 numër 6

Gjatë shiqimit të vendngjarjes, trupi gjykues ka shkuar në dhomën e gjumit në katin e dytë të shtëpisë së Vilson Nikollës nga e cila ai ka thënë se kishte një pamje të qartë të shtëpisë së Rrok Bezhit. Trupi gjykues gjeti se Vilson Nikolla ka mundur të identifikojë veturën përpara shtëpisë së Rrok Bezhit dhe të njohë persona që qëndronin tek Kryqi ngjitur me pronën e Bezhit dhe/ose përpara shtëpisë së Bezhit.

Rreth orës 09:00 ai është larguar nga shtëpia e tij dhe ka shkuar në këmbë tek shtëpia e Anton Nikollës⁸. I pandehuri dhe Rrok Bezhi vazhdonin të qëndronin përpara shtëpisë së Rrok Bezhit. Përsëri, gjatë shiqimit të vendngjarjes, trupi gjykues gjeti se nga rruga ngjitur me shtëpinë e Vilson Nikollës ai ka mundur të njohë personat që qëndronin në apo ngjitur me pronën e Bezhit.

Vilson Nikolla ka dëshmuar se ai ka qëndruar në shtëpinë e Anton Nikollës rreth 1 (një) orë⁹. Pastaj ai ka shkuar në shtëpi në këmbë.

Vilson Nikolla ka dëshmuar se i pandehuri dhe Rrok Bezhi ishin akoma jashtë shtëpisë së Rrok Bezhit.

Vilson Nikolla ka dëshmuar se rreth orës 10 - 10.30 ai ishte në oborrin e shtëpisë së vëllait të tij Ndrec Nikolla¹⁰ kur ai ka dëgjuar të shtëna arme që vinin nga drejtimi i Urës. Ai ka pasur përshtypjen se të shtënat ishin nga disa armë automatike, të shtëna në të njëjtën kohë. Ai ka shkuar në ballkonin e katit të parë dhe ka qëndruar në një parmak të ngushtë disa centimetra nga toka dhe nga kjo pozitë ai ka shikuar në drejtim të Urës. Ai nuk ka mundur të shohë ndonjë person në apo afër veturës.

Ngjarjet për të cilat dëshmitari ka dhënë dëshmi kanë ndodhur më shumë se gjashtë vjet përpara shiqimit të vendngjarjes në një stinë tjetër. Duke pasur parasysh këto fakte, nuk është befasuese që pamja e vendit ka ndryshuar. Ishte e pamundur për trupin gjykues që të përcaktojë me siguri nëse Vilson Nikolla ka mundur të shohë kupolën e makinës. Trupi gjykues ka mundur të shohë qartë një makinë të policisë e parkuar në rrugën Prizren-Gjakovë përtej Urës. Ura gjendej në një nivel më të ulët në rrugë.

⁸ Prova C1 numër 2

⁹ Në dëshminë e tij në gjykimin e parë ai ka vlerësuar mes 30 dhe 40 minuta.

¹⁰ Numër 10 Prova C1

Megjithatë, Mercedesi i të ndjerëve ishte ndaluar afër Urës.

Vilson Nikolla ka dëshmuar se Opel Vectra ishte e ndaluar jashtë shtëpisë së Rrok Bezhit.

Ai ka përshkruar se ka ecur shpejt përgjatë shtegut¹¹ nga shtëpia e vëllait¹² të tij në drejtim të rrugës kryesore.

Ndërsa ai ecte përgjatë shtegut¹³ në drejtim të rrugës kryesore ai ka parë Opel Vectrën duke vozitur mbrapsht nga prona e Bezhit gjatë rrugës në drejtim të Urës. Ai nuk ka mundur të shohë sa persona ishin në veturë. Ai ka dëshmuar se nuk ka mundur të njohë vozitësin. Megjithëse trupi gjykues gjeti se Vilson Nikolla ka mundur të njohë persona që qëndronin në/afër pronës së Bezhit nuk do të ishte kaq e lehtë që të njihej dikush i ulur në veturë.

Vetura ka vozitur mbrapsht rreth 50 metra. Vetura është ndaluar. Vozitësi ka dalur dhe është ulur në ulësen prapa. Gjatë ekzaminimit të tij me datë 2 shtator 2010 ai ka thënë se ka kuptuar se personi që kishte vozitur mbrapsht veturën në drejtim të vendngjarjes ishte Leonard Nokaj vetëm atëher kur Opel Vectra e ka kaluar atë. Ai ka parë tre persona që vraponin nga Ura në drejtim të Opel Vectrës. I pandehuri ishte njëri nga këta tre persona. Ai kishte vënë një kapele. Ai ka dëshmuar se kishte parë të pandehurin që kishte vënë të njëjtën kapele më herët atë ditë ndërsa qëndronte duke biseduar me Rrok Bezhin. I pandehuri ndiqej nga Anton Nokaj dhe Simon Nokaj. Të tre mbanin armë të gjata. Kjo është në përputhje me deklaratën e datës 25 shkurt 2005.

Pastaj ai ka parë Rrok Bezhin afër shtëpisë së tij. Edhe ai mbante diçka në dorë por ai nuk ka mundur të shohë se çfarë ishte. Rrok Bezhi ka hapur derën e shtëpisë së tij, ka futur brenda sendin që mbante dhe ka vrapuar në drejtim të rrugës.

Opel Vectra është ndaluar afër Kryqit, afër shtëpisë së Rrok Bezhit dhe Rrok Bezhi është futur në makinë.

Opel Vectra shkoi gjatë rrugës në drejtim të dyqanit dhe afër vendit ky qëndronte Vilson Nikolla. Vilson Nikolla

¹¹ Prova C1 numër 11

¹² Prova C1 numër 10

¹³ Prova C1 numër 11

qëndronte në shteg mes shtëpisë së Nrec Nikollës dhe rrugës kryesore përballë dyqanit.

Vilson Nikolla ka vlerësuar se Opel Vectra ka kaluar atë në një distancë rreth 20 - 30 metra dhe me shpejtësi rreth 30 - 40 km/orë. Ai ka parë pjesën përpara të veturës ndërsa ajo i afrohej dyqanit. Ai ka parë se personat në veturë ishin i pandehuri, Anton Nokaj, Simon Nokaj, Leonard Nokaj dhe Rrok Bezhi. Ai ka thënë se i pandehuri ishte duke vozitur. Kjo është në përputhje me deklaratën e tij të datës 25 shkurt 2005. Ai dëshmoi se ka parë një Kalashnikov në kraharorin e të pandehurit.

Opel Vectra ka ngadalësuar kur po afrohej dyqanit. Ajo nuk është ndaluar. Ai tha se dritarja e vozitësit ishte gjysmë e hapur. Ai tha se i pandehuri ka thënë diçka Pren Hilit i cili qëndronte jashtë dyqanit. Ai nuk ka dëgjuar atë që është thënë. Pastaj vetura ka vazhduar në drejtim të fshatit. Trupi gjykues gjeti se nga pozita e tij në shteg në anën tjetër të rrugës nga dyqani, ai ka pasur mundësi të vërejë nëse dritarja e vozitësit ishte e hapur.

Në deklaratën e tij të datës 25 shkurt 2005 ai tha se ka dëgjuar nga njerëzit që qëndronin përpara dyqanit se i pandehuri i kishte thënë Pren Hilit "*E kreuva misionin*". Këto janë thashetheme.

Më tej, gjatë shiqimit të vendngjarjes trupi gjykues gjeti se nga pozita e tij në shteg Vilson Nikolla ka pasur mundësi të njohë personat në veturë.

Pastaj ai ka dëgjuar të shtëna të tjera nga një armë automatike. Të shtënat vinin nga fundi i fshatit. Trupi gjykues gjeti se i pandehuri dhe anëtarë të tjerë të familjes Nokaj banojnë aty.

Vilson Nikolla ka dëshmuar se ai po qëndronte përpara dyqanit kur Luz Allakaj ka vozitur deri aty dhe ka ndaluar veturën përpara dyqanit. Ai dëshmoi se Luz Allakaj ka pyetur se çfarë kishte ndodhur? Vilson Nikolla i ka thënë Luz Allakajt se vëllezërit e tij ishin qëlluar.

Vilson Nikolla është vozitur nga Anton Nikolla deri tek Ura.

Kur ka arritur në vendngjarje Luz Allakaj ishte duke folur me Tune Allakaj. Ai tha se nuk ka mundur të dëgjojë bisedën e tyre.

Tune Allakaj është transferuar në veturën Passat. Vilson Nikolla ka vozitur veturën Passat deri në spital në Gjakovë. Anton Nikolla e ka shoqëruar atë në veturë. Ai ka vlerësuar se rrugëtimi deri në spital ka zgjatur rreth 10 - 15 minuta.

Vilson Nikolla dëshmoi se gjatë rrugës për në spital Tuna ka përsëritur dy apo tre herë emrat e personave që ai tha se kishin shtënë në veturë duke qëlluar atë dhe Dede Allakaj. Ai tha se ishte Danili, Simoni, Antoni dhe Rrok Bezhi. Në deklaratën e tij të datës 25 shkurt 2005 ai tha se Tuna kishte përmendur Danilin, Simonin, Antonin, Rrok Bezhin dhe Leonardin. Në dëshminë e tij përpara Gjykatës ai nuk ka mundur të kujtohet se Tune Allakaj ka përmendur Leonard Nokajn.

Gjin Preqi ka dëshmuar në gjykimin e parë me datë 7 maj 2009. Ai është intervistuar nga Prokurori me datë 8 gusht 2005 dhe 31 korrik 2008.

Gjin Preqi është pronari i kafes në fshatin Bishtazhin. I pandehuri ishte klient i rregullt. Gjin Preqi dëshmoi se ai njeh familjen Nokaj dhe Luz Allakaj. Ai tha se e ka njohur të pandehurin që nga shkolla. Ai dhe i pandehuri ishin më tepër se thjesht të njohur. Në fakt, ka ndodhur që ata të takohen për kafe.

Gjin Preqi dëshmoi se ai dhe i pandehuri kanë shkëmbyer numrat e telefonave mobilë. Atij nuk i kujtohej kur.

Në momentin e ngjarjes numri i telefonit mobil të Gjin Preqit ishte 044 136 648. Nuk është kontestuar fakti se 044 127 118 ishte numri i telefonit të të pandehurit.

Gjin Preqi dëshmoi se ditën në fjalë rreth orës 10 - 10.30 ai ishte në varrezat e Gradishit, rreth 2 - 2.5 kilometra nga fshati Marmullë kur ai ka dëgjuar rreth 3 apo 4 rafale nga armë zjarri që vinin nga drejtimi i Marmullës.

Ai dëshmoi se rreth orës 10.30 - 10.40 ai ka thirrur në telefon të pandehurin për të cilin ai dinte se jetonte në fshat sepse ai donte të dinte se çfarë kishte ndodhur.

Gjin Preqi dëshmoi se kur i pandehuri është përgjigjur në telefon ai e ka pyetur "Ça ka të re, sepse dëgjova të shtënat?" dhe i pandehuri i është përgjigjur "Kemi vrarë Allakajt dhe marrë gjakun". Ai tha se kishte pyetur të pandehurin "Ku?" dhe i pandehuri i është përgjigjur "Ura e Jakës". Pastaj ai ka pyetur të pandehurin "Kë?". I pandehuri është përgjigjur "Dedën dhe Tunën". Gjin Preqi dëshmoi se i pandehuri fliste si pafrymë. Dëshmia ishte në çdo aspekt material në përputhje me dëshminë e dhënë me datë 8 gusht 2005 dhe 7 maj 2009.

Palët janë pajtuar lidhur me shënimet e regjistrimeve të thirrjeve telefonike të bëra nga telefoni mobil i Gjin Preqit.

Këto të dhëna tregojnë se në orën 10.41 me datë 19 mars 2004, është bërë një telefonatë nga telefoni i Gjin Preqit në telefonin mobil të të pandehurit. Kjo është në përputhje me tregimin e tij që i ka telefonuar të pandehurit.

Është interesant fakti se, këto të dhëna tregojnë gjithashtu se në orën 13.24 me datë 18 mars 2004 Gjin Preqi kishte bërë një telefonatë në telefonin mobil të të pandehurit. Kjo telefonatë ka zgjatur 1 minutë e 2 sekonda. Gjin Preqi është pyetur lidhur me këtë telefonatë. Ai dëshmoi se kishte telefonuar të pandehurit për ta ftuar atë për një kafe. Ai tha se ka takuar të pandehurin më vonë atë ditë.

Gjin Preqi ka vozitur deri në vendngjarje me Sokol Preqin. Kur kanë arritur ai ka parë Mercedesin të ndaluar në rrugë. Dedë Allakaj gjendej akoma në veturë.

Pastaj Gjin Preqi ka shkuar në Gjakovë me Sokol Preqin për të blerë sende personale në dyqanin afër spitalit. Atij nuk i kujtohej emri i dyqanit. Ndërsa ai thotë se aty jashtë spitalit ka parë një turmë. Kjo ishte një rastësi pak e tepërt për tu konsideruar si e tillë. Duket më shumë se Gjin Preqi po kërkonte të mësonte lidhur me këtë. Ai tha se ishte ndaluar për të marrë vesh se çfarë ishte duke ndodhur. Pastaj ai ka ndjekur ambulancën deri në spital. Në veturë gjendeshin edhe Sokol Preqi, Gjon Nikolla dhe Luz Allakaj.

Gjin Preqi pritej që të merrte pjesë në varrimin e xhaxhait të tij në varrezën në Gradish në orën 14:00 atë pasdite. Ai është kthyer në shtëpi pas varrimit.

Avokati mbrojtës ka insistuar në faktin se Gjin Preqi kishte vozitur Luz Allakajn në spital në Prishtinë. Avokati mbrojtës kërkoi të sugjerojë se Gjin Preqi ishte në anën e palës së dëmtuar. Gjykata nuk e ka pranuar këtë pohim. Duket se Gjin Preqi kishte raporte shoqërore me të dy, të pandehurin dhe anëtarët e familjes Allakaj. Nuk ka pasur prova që sugjerojnë se Gjin Preqi ka pasur ndonjë inat kundër të pandehurit. Nuk ka prova se dëshmia e Gjin Preqit është dhënë me qëllim që të ndihmojë prokurorinë.

Mikel Berisha në kohën e gjyqimit ishte me banim në Poloni.

Trupi Gjykses është i mendimit se sigurimi i pranisë së tij në Gjykatë do të paraqiste vështirësi të konsiderueshme dhe do të vononte në mënyrë të pashmangshme përfundimin e gjyqimit. Në këto rrethana, në pajtim me nenin 368 të KPPK, Gjykata ka pranuar me anë të një vendimi të datës 30 shtator 2010 procesverbalin e dëshmisë së dhënë nga Mikel Berisha me datë 4 gusht 2005. Gjykata ka bërë një interpretim të ngushtë të dispozitave të nenit 368 dhe ka pranuar vetëm dëshminë e mëparshme dhe jo deklaratat e mëparshme të dhëna pa betim. Gjatë vlerësimit të dëshmisë së mëparshme të Mikel Berishës Gjykata ka qenë e ndërgjegjshme për dispozitat e nenit 157 të KPPK.

Mikel Berisha ka deklaruar se ai qëndronte pranë deklaratës së tij të datës 28 prill 2004.

Gjykata vendosi të mos mbështetet në dëshminë e Mikel Berishës në vendimin e aktgjyqimit të saj. I pandehuri nuk kishte pasur mundësinë që të kundërshtojë dëshminë e Mikel Berishës në gjykimin e tij të parë dhe atij i është mohuar mundësia për të kundërshtuar këtë dëshmi përpara kësaj Gjykate. Në këto rrethana, Gjykata konkludoi se nuk do të ishte në interes të drejtësisë që të mbështetej në të.

Mhill Berisha është intervistuar nga Prokurori me datë 30 dhjetor 2005. Ai ka dhënë dëshmi në gjykimin e Anton Nokajt me datë 31 mars 2005.

Ai nuk ka mundur të tregojë shtëpinë e tij duke u bazuar në fotografinë ajrore¹⁴. Megjithatë, gjatë shiqimit të vendngjarjes, trupi gjykues ka vizituar shtëpinë e tij dhe e ka identifikuar atë në fotografinë ajrore¹⁵.

Mhill Berisha ka njohur të pandehurin që nga fëmijëria. Ai dëshmoi se nuk shoqërohet me anëtarët e familjes Nokaj.

Mhill Berisha dëshmoi se ditën në fjalë rreth orës 10.30 ai ishte në shtëpi duke parë televizor. Ai ka dëgjuar të shtëna me armë "nga fundi i fshatit". Atij nuk i kujtohej sa të shtëna. Më vonë ai dëshmoi se ka dëgjuar një të shtënë.

Ai ka dalur jashtë. Ai tha se nuk ka parë veturë. Ai ka dëshmuar disa herë se nuk kishte parë asgjë. Ai dëshmoi se ditën në fjalë nuk ka parë asnjë anëtarë të familjes Nokaj në fshat.

Ai tha se më vonë ka dëgjuar të shtëna nga shtëpia e Anton Nokajt.

Dëshmia që Mhill Berisha ka dhënë përpara Gjykatës ka qënë në kundërshtim në disa aspekte materiale të rëndësishme me dëshminë që ai ka dhënë me datë 31 mars 2005 dhe 30 dhjetor 2005.

Mhill Berisha nuk din të lexojë. Dëshmia që ai ka dhënë me datë 31 mars 2005 është shënuar në procesverbalin e gjykimit të Anton Nokaj. Në fund të procesverbalit të dëshmisë së tij të datës 30 dhjetor 2005 gjendet një deklaratë që thotë se procesverbali i është lexuar dëshmitarit dhe se ai e ka nënshkruar atë pa kundërshtime. Mhill Berisha ka konfirmuar se nënshkrimi në procesverbal ishte i tij por atij nuk i kujtohej që i ka nënshkruar.

Në dëshminë e tij të datës 31 mars 2005 Mhill Berisha ka deklaruar se ditën në fjalë ai ka dëgjuar të shtëna armësh. Ai ka dalur në ballkonin e katit të tretë të shtëpisë së tij. Rreth 7 - 8 minuta më vonë ai ka parë një Opel Vectra. Ai ka dëshmuar se ajo vinte në drejtim të shtëpisë së Anton Nokaj. Ajo është ndaluar afër derës së shtëpisë së tij. Ai ka përshkruar të pandehurin, Rrok Bezhin, Anton Nokajn, Simon Nokajn dhe një person tjetër të cilin nuk e

¹⁴ Prova C1

¹⁵ Numër 13 prova C1

ka njohur që zbrisnin nga kjo veturë. Ai tha se pandehuri ka shtënë në ajër. Pastaj i pandehuri hapi portën e oborrit të tij dhe u largua me veturën e tij BMW.

Gjatë ekzaminimit të tij nga Prokurori në dhjetor 2005 Mhill Berisha deklaroi se ditën në fjalë në orën 10:00 ai ishte në oborr përpara shtëpisë së tij kur ai ka dëgjuar të shtënat me armë. Ai tha se është ngjitur në ballkonin e katit e "pestë"¹⁶ të shtëpisë së tij për të parë se çfarë kishte ndodhur. Në dëshminë e tij të datës 31 mars 2005 ai tha; kati "tretë". Gjykata gjen se ky konfuzion ishte rezultat i dy gjërave. Së pari, në anglishten e folur në Amerikë, kati përdhese quhet kati i "parë". Së dyti, bodrumi është përfshirë në numërimin e kateve.

Gjatë shiqimit të vendngjarjes Trupi gjykues ka shkuar në katin e dytë dhe të tretë të shtëpisë së Mhill Berishës. Nga ballkoni i katit të dytë dhe të tretë portat e hyrjes në oborrin e të pandehurit shihen qartë.

Pas rreth 7 - 8 minutash ai ka parë një Opel Vectra që shkante në drejtim dhe është ndalur tek shtëpia e të pandehurit. Ai tha se i pandehuri, Anton Nokaj, Simon Nokaj dhe Rrok Bezhi kanë dalur nga vetura.

Ai deklaroi se i pandehuri ka shtënë në ajër me një Kallashnikov përpara se të voziste veturën e tij në drejtim të veriut në drejtim të "shtëpisë së Gojanit". Të tjerët kanë hyrë në veturën Opel Vectra që është larguar në drejtim të shtëpisë së Anton Nokajt.

Mentor Bytyqi ishte teknik i punësuar në spitalin e Gjakovës.

Mentor Bytyqi ka dëshmuar me datë 31 mars 2005 në gjykimin kundër Anton Nokaj. Ai ka përshkruar Tuna Allakajn duke arritur në spital. Ai tha se Tuna i ka thënë se kishte dhimbje. Ai dëshmoi se "Vëllai i Tunës" ka folur me Tunën në repartin e mjekimit intensiv të spitalit përpara se ai të transferohej në Prishtinë.

Më tej, Mentor Bytyqi dëshmoi me datë 14 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit. Ai ka përshkruar mbërritjen e Tunë Allakajt në spital. Ai dëshmoi se Tuna ka mundur të dalë nga vetura pa ndihmë. Përpara se të futej

¹⁶ Prova C1 numër 13

në Repartin Intensiv Tuna ka thënë se vëllai i tij ishte vrarë.

Mentor Bytyqi dëshmoi se ai ka pyetur Tunën se çfarë kishte ndodhur. Ai është përgjigjur se e kishin qëlluar.

Mentor Bytyqi ka shoqëruar Tunën në spital në Prishtinë. Gjatë rrugës ai ka folur me Tunën. Ai ka thënë përsëri se kishte dhimbje. Duket se gjatë rrugës Tuna ishte i kthjellët dhe i kuptueshëm. Ai ka vdekur gjatë rrugës për në Prishtinë.

Gjok Komani ishte doktor në Urgjencë në spitalin e Gjakovës. Ai është intervistuar nga Prokurori me datë 27 prill 2004. Ai ka dëshmuar me datë 5 prill 2005 në gjykimin kundër Anton Nokaj. Më tej ai ka dëshmuar me datë 14 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit.

Në intervistën e tij të datës 27 prill 2004 Gjok Komani ka deklaruar se ditën në fjalë ai ka parë Tunë Allakajn. Ai nuk ishte në detyrë. Edhe Luz Allakaj ishte i pranishëm. Ai nuk ka dëgjuar as Luz Allakajn as Tune Allakajn të thonë ndonjë gjë. Sipas mendimit të tij Tunë Allakaj nuk do të kishte mundur të fliste duke pasur parasysh plagët e tij.

Ai ka dhënë edhe një deklaratë tjetër me datë 5 prill 2005 lidhur me incidentin. Në këtë deklaratë ai tha se Tune Allakaj tha se ishte "OK" dhe se ishte në gjendje ta kuptonte atë qartë. Lidhur me këtë dëshmia e Dr. Komani ishte jokoherente.

Në dëshminë e tij të datës 14 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit Gjok Komani tha se Tune Allakaj kishte pësuar një plagë në fytyrë. Ai kishte gjak në gojë. Ai tha se Tunë Allakaj e kishte të vështirë të artikulojë fjalët e tij por ai ka menduar se duke iu përgjigjur një pyetjeje, Tunë Allakaj ka thënë "po, po, po marr frymë".

Dr. Komani është pyetur lidhur me mungesën e koherencës me deklaratën e tij të muajit prill 2004 kur ai ka thënë se Tunë Allakaj nuk mund të fliste. Ai ka spjeguar këtë duke thënë "Kur kam arritur në atë moment ai nuk kishte gjakderdhje të madhe dhe në disa raste është përdorur aspiratori për të pastruar gojën e tij. Përkthimi i deklaratës sime origjinale është i gabuar. Ishte një

tingull shumë i paqartë dhe nuk kam mundur ta dëgjoj atë shumë mirë.”

Anton Nikolla ka dhënë deklaratë në polici me datë 19 mars 2004, kemi një procesverbal të dëgjimit të dëshmitarit të datës 6 prill 2004, procesverbali nga gjykimi kundër Anton Nokajt i datës 2 mars 2005, dhe intervista me prokurorin e datës 31 korrik 2008 dhe dëshmia që ai ka dhënë në gjykimin e parë kundër të pandehurit me datë 6 maj 2009.

Ditën në fjalë në orën 10.30 ai ka dëgjuar të shtëna armësh nga drejtimi i Urës. Ai tha se dinte se atë mëngjes anëtarët e familjes Allakaj do të udhëtonin për në Gjakovë. Ai e dinte se familja Allakaj ishte e përfshirë në një gjakmarrje. Ai ka vozitur deri tek Ura. Gjatë rrugës ai pa një veturë që po udhëtonte në drejtimin e kundërt. Ai e përshkroi veturën si një "Opel Kadett". Ai ka njohur në atë veturë Anton Nokajn dhe Rrok Bezhin. Pastaj ai ka arritur tek Ura dhe ka gjetur të vdekurin.

Në deklaratën e tij të datës 6 prill 2004 Anton Nikolla ka thënë se ditën në fjalë rreth orës 10:00 ai ka dëgjuar të shtëna me armë nga drejtimi i Bishtazhinit. Ai ka përshkruar se ka parë një "Vectra" që ka kaluar atë përpara shtëpisë së tij. Ai ka njohur në veturë Anton Nokajn dhe Rrok Bezhin. Ka qenë edhe një person tjetër duke vozitur veturën të cilin ai nuk e ka njohur. Ai ishte në dijeni për gjakmarrjen mes familjes Allakaj dhe familjes Nokaj. Më tej, ai dinte se disa anëtarë të familjes Allakaj do të udhëtonin për në Gjakovë. Gjatë rrugës për në Urë ai ka parë Luz Allakajn. Luz Allakaj e ka pyetur atë çfarë kishte ndodhur. Anton Nikolla është përgjigjur "duket se i kanë vrarë".

Anton Nikolla deklaroi se ai ka vozitur deri në vendngjarje. Kur ai ka arritur ai ka parë vrimat e plumbave në Mercedes. Ai ka kuptuar se Dede Allakaj kishte vdekur. Tune Alakaj ishte i ulur në ulësen e vozitësit. Ai përshkroi se Luz Allakaj dhe Gjon Nikolla kanë nxjerrë Tunën nga vetura. Pastaj ai dhe Vilson Nikolla kanë vozitur Tunën në spital në Gjakovë.

Në dëshminë e tij më datë 2 mars 2005 në gjykimin kundër Anton Nokajt, Anton Nikolla ka përshkruar se ka parë Anton Nokajn dhe Rrok Bezhin në veturën Vectra. Ai dëshmoi se Rrok Bezhi ishte i ulur në ulësen prapa dhe Anton Nokaj ishte i ulur në ulësen e pasqerit përpara.

Në dëshminë e tij në gjykimin e parë të të pandehurit me datë 6 maj 2009 Anton Nikolla ka thënë se ishte në oborrin e shtëpisë së tij kur ka dëgjuar tre rafale nga armë zjarri që kanë bërë zhurmë të ndryshme. Të shtënat janë bërë njëra pas tjetrës me interval sekondash me tyre.

Rreth pesë minuta pasi ka dëgjuar të shtënat ai ka përshkruar se ka parë një Opel Vectra që ka kaluar afër shtëpisë së tij dhe ai tha se ka njohur Anton Nokajn dhe Rrok Bezhin në veturë. Ai tha se ka qenë 5 metra larg dhe Vectra po ecte me shpejtësi rreth 50 km/orë.

Në dëshminë e dhënë në gjykimin e parë të të pandehurit ai ka thënë se në veturë ishin katër persona. Ai ka njohur Anton Nokajn dhe Rrok Bezhin. Ai tha se nuk ka mundur të njohë personin e katërt në veturë. Ai është pyetur lidhur me këtë në gjykimin e parë të të pandehurit. Në gjykatë ai dëshmoi se nuk ka mundur të shohë vozitësin e veturës. Ai ka mohuar të ketë pasur frikë.

Anton Nikolla ka vozitur në drejtim të Urës. Gjatë rrugës ai është ndalur tek dyqani. Vilson Nikolla deklaroi "shko i thuaju Allakajve se familja Nokaj ka vrarë dikë të familjes Allakaj". Ai tha se ka vozitur dhe është kthyer në drejtim të fshatit. Gjatë rrugës ai ka takuar Luz Allakajn. Anton Nikolla i ka thënë atij se Nokajt kishin vrarë Dedën dhe Tunën.

Luz Allakaj ka arritur i pari në vendngjarje. Gjon Nikolla, Anton Nikolla dhe Vilson Nikolla kanë arritur pastaj.

Vilson Nikolla ka vozitur Tunën deri në spital në Gjakovë. Anton Nikolla i ka shoqëruar ata. Në dëshminë e tij në gjykimin e parë të të pandehurit ai ka përshkruar një bisedë mes Tune Allakaj dhe Vilson Nikollës gjatë rrugës për në spital në Gjakovë. Ai ka dëshmuar se Tuna ka dashur të thotë diçka. Vilsoni e ka ndalur atë. Ai tha se ka dëgjuar Tunën të përmendë emrin Rrok.

Zef Delija ka dëshmuar me datë 6 prill 2005 në gjykimin kundër Anton Nokajt. Ai tha se ditën në fjalë rreth orës 09 - 09.30 Rrok Bezhi ka hyrë në dyqanin e tij dhe ka kërkuar një grabujë për oborrin e tij.

Rreth orës 11 ai ka dëgjuar të shtëna. Ai ka dalë jashtë dhe ka shikuar në drejtim të Urës. Ai tha se ka parë Rrok Bezhin në oborrin e shtëpisë së tij. Pastaj ai ka përshkruar se ka parë një veturë që është afruar dyqanit të tij me shpejtësi të madhe. Ai tha se nuk ka parë kush ishte në veturë sepse kontinjeri i mbeturinave i bllokonte pamjen.

Robert Delija ka dëshmuar me datë 5 prill 2005 në gjykimin kundër Anton Nokajt se ditën në fjalë ai ishte në dyqan. Ai ka përshkruar se ka parë Zef Delinë dhe Rrok Bezhin duke kaluar aty, duke shkuar në drejtim të shtëpisë së Bezhit. Rrok Bezhi mbante një grabujë. Kjo ishte rreth orës 09 - 09.30am.

Ai ka përshkruar se ka dëgjuar një rafal nga armë zjarri. Ai ka dalur jashtë dhe shikuar në drejtim të Bistrashinit sepse ai tha se të shtënat vinin nga ai drejtim. Ai ka përshkruar se ka parë Rrok Bezhin në oborrin e tij. Ai tha se pas 20 sekondash ka dëgjuar të shtëna të tjera.

Pas të shtënave ai ka parë një Opel Vectra që ecte me shpejtësi të madhe. Ai nuk ka mundur të shohë kush ishte në veturë sepse një kontinjeri i mbeturinave i madh i bllokonte pamjen.

Ai ka përshkruar se më vonë atë ditë ka dëgjuar të shtëna të tjera që vinin nga fshati Marmullë.

Në dëshminë e tij të datës 29 prill 2004 Robert Delija ka deklaruar se kur ka dëgjuar të shtënat e para ai ka parë Rrok Bezhin në oborrin e shtëpisë së tij. Dukej sikur po punonte me grabujë.

Pren Hili ka deklaruar me datë 27 prill 2004 se ditën në fjalë ai ka qenë në dyqan kur ka vërejtur Rrok Bezhin në oborrin e shtëpisë së tij.

Rreth 3 - 4 minuta pasi që ka hyrë në dyqan ai ka dëgjuar një rafal të shtënash nga drejtimi i Bishtazhinit. Menjëherë pastaj është dëgjuar një rafal të shtënash tjetër. Rrok Bezhi ishte akoma në oborrin e tij.

Rreth katër minuta pas të shtënës së dytë, një veturë Opel Vectra me ngjyrë të kaltër të mbyllur kaloi me shpejtësi. Po vinte nga drejtimi i Bishtazhinit drejt qendrës së Marmulles. Pren Hilli dëshmoi se ishte rreth 3 metra larg

veturës. Tha se e pa vozitësin, por nuk e njohu atë. Nuk pa se kishte pasagjerë të tjerë në veturë.

Kur dëshmoi më 13 prill 2005 në gjykimin e Anton Nokajt, ai deklaroi se ishte në dyqan dikur pas orës 10. Ai përshkroi të ketë parë veturën e të ndjerit duke i kaluar pranë. Shpejt pas kësaj, ai dëgjoi të shtëna armësh.

Së bashku me persona të tjerë, ai u largua nga dyqani dhe qëndroi para dyqanit me drejtim drejt fshatit. Ai përshkroi të ketë parë një person në kopshtin e Rrok Bezhit. Ai mendoi se ishte Rrok Bezhi, por pranoi se ka mundur të jetë njëri prej vëllezërve të tij. Pas një kohe të shkurtër, kaloi vetura Opel Vectra me ngjyrë të kaltër të mbyllur, e Anton Nokajt. Ai dëshmoi se vetura po kalonte me shpejtësi të madhe. Pas kësaj, dëgjoi të shtëna të tjera arme. Ai dëshmoi se nuk ia doli të shohë personat brenda në veturë për shkak se pamjen ia kishte zënë një kontenier mbeturinash.

Kur dëshmoi më 21 tetor 2005, Pren Hili deklaroi se në ditën në fjalë, në veturën Opel Vectra ishin Anton Nokaj, Danil Nokaj dhe Simon Nokaj. Simon Nokaj ishte ulur në prapa në makinë, mu pas vozitësit. Ai besoi se ishte 3 - 4 metra nga vetura kur i kaloi kjo e fundit. Vetura po ecte me shpejtësi 30 - 40 KPH. Pren Hili dëshmoi se këtë nuk e ka deklaruar më parë për shkak të frikës nga familjes Nokaj.

Kur dëshmoi më 13 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit, ai tha se ditën në fjalë, kishte qenë në dyqan kur kaloi vetura Mercedes e të ndjerit. Pas kësaj, dëgjoi të shtëna armësh. Përshkroi të ketë dëgjuar dy të shtëna armësh, njëra pas tjetrës. Doli jashtë.

Ai përshkroi veturën që i kaloi pranë. Kishte qenë rreth 5 - 6 metra larg veturës kur kjo e fundit kaloi. Kur po pyetej lidhur me deklaratën e tetorit 2005 ku ka thënë se ka parë të pandehurin, Anton Nokaj dhe Simon Nokaj në veturë, ai dëshmoi se nuk ka parë se kush kishte qenë në veturë për shkak se kontenieri i mbeturinave jashtë dyqanit i kishte penguar pamjen.

Biter Prekaj dha deklaratë më 8 gusht 2008, duke thënë se kishte qenë zyrtar i Shërbimit Korrektues në Burgun në Pejë. Njëri prej personave që mbaheshin aty ishte Rrok Bezhi. Ai tha se Rrok Bezhi i kishte thënë atij se i

pandehuri, Anton Nokaj, Simon Nokaj dhe Leonard Nokaj ishin përgjegjës për vrasjen e Tune dhe Dede Allakaj.

Kur dëshmoi më 18 maj 2009 në gjykimin e parë kundër të pandehurit, ai mohoi të ketë folur me Rrok Bezhin lidhur me vrasjen e vëllezërve Allakaj. Ai tha se kishte dëgjuar Rrok Bezhin duke iu referuar faktit se Anton Nokaj dhe Simon Nokaj ishin dënuar për vrasjet. Ai dëshmoi se Rrok Bezhi asnjëherë nuk kishte përmendur të pandehurin. Ai mohoi të ketë përmendur të pandehurin në deklaratën e tij të mëparshme.

Dëshmia e këtij dëshmitari lidhur me çfarë thotë se ka thënë Rrok Bezhi është me të dëgjuar.

Anton Marku dëshmoi më 17 mars 2005 gjatë gjykimit kundër Anton Nokaj. Në 10.15 - 10.30, kishte qenë në Marmulle kur dëgjoji të shtëna armësh. Shkoi në dyqan. Atje takoi Prek Gjogjen, Nikole Delijajn, Pren Hilin dhe të tjerët.

Ai përshkroi veturën Opel Vectra të Anton Nokaj duke kaluar pranë dyqanit. Ai tha se kjo e fundit po ecte ngadalë për shkak të policit të shtrirë dhe për shkak të njerëzve para dyqanit. Ai dëshmoi se ishin 5 persona në veturë. Ai tha se nuk njohi asnjërin prej tyre.

Ai tha se nuk e ka parë Rrok Bezhin në kopshtin e shtëpisë së tij as para e as pasi që dëgjoji të shtënat prej armëve.

Prene Nokaj dëshmoi më 12 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit se në mëngjesin e ditës kritike, i pandehuri po punonte në kopshtin e shtëpisë së familjes duke mbjellur qepë dhe hudhra. Ajo dëshmoi se i kishte dërguar kafe dhe ujë.

Ajo dëshmoi se dëgjoji një të shtëne. Nuk i kujtohej koha, por deklaroi se ishte gjatë mëngjesit. Ajo nuk e dinte se sa herë është shtëne. Ajo mendoi se të shtënat ishin nga arma automatike. Ajo tha se i pandehuri ishte akoma në kopsht kur dëgjoji ajo të shtënat e para. Ajo tha se e pyeti të pandehurin për të shtënat. Dëshmoi se i pandehuri shkoi për të parë se çfarë kishte ndodhur. Ajo u fut brenda në shtëpi. Dëshmoi se pas kësaj ka folur me të shoqen e të pandehurit, e cila kishte deklaruar se kishte parë Anton Nokaj me armë zjarri, duke shtëne në ajr. E shoqja e të pandehurit i kishte thënë se Allakajt ishin

vrarë. Ajo mendoi se kjo bisedë u zhvillua 10 - 20 minuta pasi që dëgjoi të shtënat.

Ajo ishte shumë e sigurtë gjatë dëshmisë së saj se kur dëgjoi të shtënat, i pandehuri ishte në kopshtin e shtëpisë.

Trashe Nokaj dëshmoi më 12 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit se ditën kritike pa të pandehurin duke punuar në kopsht. Ajo tha se foli me të. Pas kësaj, ajo u fut sërish në shtëpi. Thotë se ishte për afërsisht ora 10 e paraditës edhe pse nuk është e sigurtë. Ajo dëgjoi një zhurmë dhe e përshkroi si "bam". Doli te dritarja. Ajo mendoi se kaluan për afërsisht 10 minuta prej bisedës me të pandehurin derisa u dëgjuan të shtënat. Ajo dëshmoi se doli jashtë dhe filloi të vraponte. Edhe i pandehuri filloi të vraponte dhe i tha asaj "çka ishte ajo?" ajo dëshmoi se i tha të pandehurit se mendoi se Anton Nokaj kishte vrarë dikë. Ajo dëshmoi se nuk kishte dëgjuar gjë para të shtënave në oborrin e Anton Nokajt. Ajo dëgjoi zërin e Anton Nokaj në oborrin e tij. Ai tha se i kishte vrarë Allakajt. Ajo tha se nuk dëgjoi të shtëna paraprake.

Trashe Nokaj dëshmoi se kishte parë të pandehurin në kopsht rreth 15 minuta para se të dëgjonte të shtënat në oborrin e shtëpisë së Anton Nokajt.

Alfred Nokaj dëshmoi më 13 maj 2009 gjatë gjykimit të parë të të pandehurit se në ditën kritike, kishte qenë duke punuar në arë kur erdhi i pandehuri dhe i tha se duhej të shkonin në shtëpi sepse Anton Nokaj kishte marrë hak. Ai tha se atë ditë nuk kishte dëgjuar të shtëna. Ai nuk e dinte se sa kishte qenë ora kur kishte folur me të pandehurin, por mendoi se kishte qenë paraditë, para orës 11.

I **pandehuri** dëshmoi se marrëdhëniet e tij me familjen Allakaj nuk ishin të mira, por as të këqija. Por përshkroi edhe një grindje të shkurtër dhe të zhurmshme me Luz Allakaj pas përfundimit të luftës.

Duke iu referuar ditës kritike, i pandehuri dëshmoi se rreth orës 10 paradite, ai kishte qenë në kopshtin e shtëpisë së tij. Ai tha se po punonte tokën. Përshkroi të ketë dëgjuar të shtëna afër. Tha se takoi tezen/hallën e tij. Ajo i kishte thënë "Antoni ka marrë hak për vdekjen e të vëllait". I pandehuri i kishte thënë Alfred Nokajt se

Antoni kishte marrë gjak. I pandehuri tha se ishte kthyer në shtëpi për të vazhduar punën në kopsht. Mohoi të jetë larguar pas kësaj me veturën e tij BMW-në të zezë.

I pandehuri është pyetur lidhur me bisedën telefonike me Gjin Preqin më 19 mars 2004, gjë për të cilën ky i fundit ka dëshmuar. Ai tha se ka pranuar një telefonatë nga dikush. Tha se nuk e dinte identitetin e telefonuesit. Thirrësi e kishte pyetur se a kishte dëgjuar të shtëna. Ky iu përgjigj duke i thënë se jo. Siç duket, kaq ishte përmbajtja e bisedës.

I pandehuri poashtu është pyetur edhe lidhur me bisedën telefonike me Gjin Preqin më 18 mars 2004. Atij nuk i kujtohej biseda. Mirëpo, e pranoi se është e mundur që Gjin Preqi ta ketë thirrur. Ai mohoi të ketë takuar Gjin Preqin pas kësaj për kafe.

I pandehuri dëshmoi se 3 apo 4 ditë pas vrasjes së Dede dhe Tune Allakaj, ai u largua nga Kosova. Ai udhëtoi për në Kroaci nëpërmjet Malit të Zi. Ai tha se kishte pasaportë të vlefshme të UNMIK-ut. Mirëpo, ai nuk ka udhëtuar me këtë pasaportë. Por tha se është futur në Mal të Zi në mënyrë të paligjshme. Pas kësaj, ai ka marrë një pasaportë të falsifikuar kroate me emrin Zlatko Prgomet. Data e lëshimit të kësaj pasaporte ishte 9 gusht 2004. Ai dëshmoi se ia doli mbanë të shkonte në Zvicër ku punoi me të kunatin. Nuk kundërshtohet fakti se i pandehuri është arrestuar në Zvicër në korrik 2007.

I pandehuri dëshmoi se më 2003 ai kishte bërë një kërkesë për leje pune për të punuar në Zvicër, kërkese kjo që nuk pati sukses. Ai tha se arsyeja për largimn e tij nga Kosova ishte vetëm ekonomike. Ai tha se e ka shtyer largimin e tij derisa i lindi gruaja. Ai mohoi që largimi i tij të ketë gjë të bëjë me vrasjet e Dede dhe Tune Allakaj.

I pandehuri dëshmoi se nuk ka parë Rrok Bezhin në mëngjesin e 19 marsit 2004.

I pandehuri dëshmoi më 21 dhjetor 2000 në gjykimin e Anton Allakaj lidhur me vrasjen e Engjell Nokaj.

I pandehuri është marrë në pyetje nga prokurori më 19 gusht 2008. Ai ishte përfaqësuar nga një avokat me përvojë gjatë marrjes në pyetje. Ai konfirmoi se nënshkrimi në proces-

verbal ishte i tij. Ai tha se nuk e ka lexuar proces-verbalin para se ta nënshkruajë.

I pandehuri dëshmoi në gjykimin e tij të parë më 21 maj 2009.

Vlerësimi i provave

Më 1 korrik 2000 Anton Allakaj, i biri i Dede Allakaj, vrau Engjell Nokaj.

Marrëdhënia në mes të familjes Allakaj dhe asaj Nokaj mund të përshkruhet si e ashpër.

Luz Allakaj si dhe disa dëshmitarë të prokurorisë dëshmuan mbi gjakmarrjen në mes të familjes Allakaj dhe asaj Nokaj.

Pajtimi në mes të këtyre dy familjeve asnjëherë nuk është arritur pas vrasjes së Engjell Nokaj, të cilët atëherë ishin në gjakmarrje. Që të dy familjet jetojnë në fshatin Marmulle. Engjell Nokaj dhe i pandehuri janë kushërinj.

Trupi Gjykes përcaktoi se në kohën në fjalë familja Allakaj dhe ajo Nokaj ishin në gjakmarrje.

I pandehuri dëshmoi se rreth orës 10 paradite, në ditën kritike ai kishte qenë në kopshtin e shtëpisë së tij. Kjo përputhet me dëshminë e Trashe Nokaj dhe atë të Prene Nokaj. Ai përshkroi të ketë dëgjuar të shtëna nga afër. Ai tha se takoi tezen/hallën e tij. Ajo i kishte thënë "Antoni ka marrë hak për vrasjen e të vëllait".

Me pretendimin se sapo është informuar se kushëriri i tij Anton Nokaj kishte vrarë anëtarë të familjes Allakaj, i pandehuri ka vazhduar të punojë tokën. Kjo nuk mund të besohet.

I pandehuri është pyetur lidhur me bisedën telefonike me Gjin Preqin më 19 mars 2004. I pandehuri dëshmoi se ka pranuar një telefonatë nga një person, i cili e kishte pyetur se a kishte dëgjuar të shtëna. Kjo përputhet me dëshminë e Gjin Preqit. Ai tha se i ka thënë thirrësit se jo. Sipas informatave për regjistrim të telefonatave, kjo bisedë ka zgjatur 20 sekonda. Ai tha se nuk e ka njohur thirrësin. Është e pakuptueshme që i pandehuri nuk e ka

ditur se thirrësi ishte Gjin Preqi. Është akoma më befasuese duke pasur parasysh faktin se ka biseduar me telefon me Gjin Preqin një ditë më parë. Gjin Preqi dëshmoi se i pandehuri dukej si pa frymë, sikur të ketë vrapuar.

Kur dëshmoi më 21 maj 2009, i pandehuri mohoi të ketë shkëmbyer numrat e telefonit me Gjin Preqin. Me këtë kundërshtohet dëshmia e Gjin Preqit.

I pandehuri është pyetur lidhur me bisedën telefonike me Gjin Preqin më 18 mars 2004. Atij nuk i kujtohej biseda në veçanti. Mirëpo, e pranoi se është e mundur se Gjin Preqi e ka thirrur. Ai mohoi të ketë takuar Gjin Preqin pas kësaj për kafe.

I pandehuri dëshmoi se nuk e ka parë Rrok Bezhin në mëngjesin e 19 marsit 2004. Me kaq, kundërshtohet dëshmia e Vilson Nikollës.

I pandehuri u largua nga Kosova 3 apo 4 ditë pas vrasjeve. Ai tha se largimi i tij ishte thjeshtë për shkaqe ekonomike dhe nuk kishte fare të bënte me vrasjet. Ka qenë e mundur se më parë ka bërë një kërkesë për marrjen e lejes së punës në Zvicër, kërkesë që iu mohua. Mirëpo, largimi i tij nuk mund të sqarohet si thjeshtë rastësi. Siç e pranoi edhe vetë, a ishte në posedim të pasaportës valide të UNMIK-ut. Mirëpo, ka vendosur që të mos përdorë këtë pasaportë për të udhëtuar nga Kosova për në Mal të Zi. Ai tha se nuk ishte i sigurt se a vlente kjo pasaportë për tranzit nga Mali i Zi. Në vend të kësaj, ai e ka rregulluar që të largohet nga Kosova me dokumente të falsifikuara. Trupi Gjykses është i mendimit se ai është përpjekur të largohet nga përgjegjësia penale për vrasjen e Tune dhe Dede Allakaj.

Trupi Gjykses gjeti se dëshmitë e Luz Allakaj, Gjon Nikolla, Vilson Nikolla dhe Gjin Preqi janë bindëse. Dëshmitë e tyre në cilësinë e dëshmitarëve në çdo aspekt material ishin konsistente. Për më tepër, në rastin e Gjin Preqit, dëshmia e tij mbështetet nga të dhënat e telefonit.

Është e pashmangshme që dëshmitarët të harrojnë apo të konfuzojnë ngjarjet për të cilat kërkohen që të dëshmojnë e sidomos kur këto ngjarje kanë ndodhur disa vite para se të dëshmojnë. Papërputhshmëritë, madje edhe kundërshtimet me dëshmitë apo deklaratat e mëparshme jo domosdoshmërisht

zvogëlojnë peshën probative të dëshmisë në fjalë. Kjo është sidomos kështu kur papërputhshmëria nuk ka të bëjë me ndonjë fakt material në çështjen në fjalë. Dëshmitarët që vëzhdojnë ngjarjen e njëjtë, nganjëherë perceptojnë gjëra të ndryshme.

Trupi Gjykses ka pasur rastin të vlerësojë besueshmërinë e secilit dëshmitar që ka dëshmuar. Sigurisht se Trupi Gjykses ka pasur mundësinë që të shqyrtojë edhe dëshmitë apo deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve, të cilët nuk dëshmuar, por dëshmia e të cilëve është pranuar.

Trupi Gjykses gjeti se Luz Allakaj është dëshmitar i aftë, i besueshëm dhe i sigurt.

Trupi Gjykses gjeti se edhe Gjon Nikolla është dëshmitar i sigurt.

Gjatë shqyrtimit kryesor është ngritur çështja e besueshmërisë së dëshmitarit në lidhje me identifikimin. Kjo ishte mjaft e rëndësishme sidomos duke pasur parasysh distancën nga e cila dëshmitarët e prokurorisë pretendonin të kenë vëzhguar të pandehurin. Në fjalën e tij përfundimtare, Avokati Mbrotjës i të pandehurit solli vëmendjen e Trupit Gjykses në faktin se gjatë inspektimit të vend-ngjarjes më 2005, Vilson Nikolla nuk ia doli të identifikonte dy zyrtarë të policisë të vendosur në vendin ku ai tha se mund të identifikojë të pandehurin.

Mirëpo, duhet bërë dallimi në mes të (a) identifikimit dhe (b) njohjes.

Shumica e dëshmitarëve të prokurorisë kishin njohur të pandehurin që nga rinia. Duke pasur parasysh këtë, Trupi Gjykses nuk trajtoi çështjen e identifikimit, por njohjes së të pandehurit nga ana e tyre.

Dëshmitari që merr pjesë në procesin e identifikimit mbase mund të hasë në vështirësi që besueshmërisht të identifikojë një të panjohur që mbase e ka parë shkarrazi, nga larg apo edhe me vizibilitet të dobët.

Dëshmitari mund të ketë më pak vështirësi të njohë nga distanca, madje edhe shkarrazi personin që e njeh një kohë të gjatë. Dëshmitari mund të njohë atë person nga karakteristikat e tij fizike, mënyra e të sjellurit apo edhe nga rrobat e veshura.

Vilson Nikolla dëshmoi se gjatë udhëtimit për në spital, Tunë kishte thënë se sulmuesit e tij ishin Danili, Simoni, Antoni dhe Rrok Bezhi. Në deklaratën e tij të dhënë më 25 shkurt 2005, ai tha se Tuna përmendi Danilin, Simonin, Antonin, Rrok Bezhin dhe Leonardin. Kur dëshmoi para Trupit Gjykses, nuk i kujtohej se Tune Allakaj kishte përmendur Leonard Nokajn.

Gjatë inspektimit të vend-ngjarjes, Trupi Gjykses kishte parasysh dëshminë e të pandehurit dhe vlerësoi atë gjatë inspektimit të vend-ngjarjes. Trupi Gjykses ishte i mendimit se është e mundur që Vilson Nikolla të ketë njohur të pandehurin nga vendi ku po qëndronte (a) në dhomën e fjetjes së shtëpisë së tij (kur i pandehuri po qëndronte te kryqi pranë pronës së Bezhit) dhe (b) rrugina nga shtëpia e Ndrec Nikollës për në dyqanin e Zef Delijajt (kur i pandehuri po vraponte drejt veturës Opel Vectra dhe kur vetura e përmendur pastaj kaloi nga dyqani i Zef Delijajt).

Vilson Nikolla dëshmoi të ketë parë të pandehurin duke vrapuar nga drejtimi i urës drejt veturës Opel Vectra. Ai tha se i pandehuri po mbante një armë. Ai tha se i pandehuri voziti veturën Opel Vectra nga vend-ngjarja. Ai tha se pas kësaj, vetura kaloi 20 - 30 metra afër tij dhe ai pa të pandehurin duke vozitur.

Kur dëshmoi para këtij Trupi Gjykses, dukej i sigurt se kishte qenë Leonard Nokaj që voziti veturën Opel Vectra nga shtëpia e Bezhit dhe drejt vend-ngjarjes. Po të kishte qenë kështu, është e pakuptueshme që Tune Allakaj të përmendte Leonardin si njëri ndër sulmuesit e tij. Mirëpo, Vilson Nikolla ishte mjaft i qartë gjatë dëshmisë së tij kur tha se nuk mund të njihte vozitësin kur po kthehej vetura. Vetëm më vonë, kur i kaloi vetura pranë, dhe nga pozicionet e tyre në veturë, ai besoi se vozitësi kishte qenë Leonard Nokaj. Mirëpo, që të dy Luz Allakaj dhe Gjon Nikolla dëshmuuan se Tuna kishte përmendur Leonard Nokajn si njëri ndër sulmuesit e tij. Në këto rrethana, ka gjasa që Vilson Nikolla të jetë gabuar kur tha se Leonard Nokaj ishte vozitësi.

Nëse Vilson Nikolla gabohet lidhur me faktin se Leonard Nokaj voziti veturën deri në vend-ngjarje, a gabohet edhe kur thotë se i pandehuri ishte njëri ndër personat që vraponte nga vend-ngjarja dhe personi i njëjtë që voziti veturën nga vend-ngjarja? Jo.

Vilson Nikolla pa vozitësin e veturës Opel Vectra duke dalë nga vetura. Ai pa tre meshkuj që vraçonin nga vend-ngjarja drejt veturës që priste. Që të tre meshkujt po bartnin armë me tytë të gjatë. Njëri nga këta tre u fut në ulësen e vozitësit në veturën Opel Vectra. Kur po i kalonte vetura, ai pa të pandehurin duke vozitur. Është e logjikshme që i pandehuri ishte një ndër personat që kishte parë Vilson Nikolla duke vrapuar nga vend-ngjarja duke bartur armë me tytë të gjatë.

Trupi Gjykses gjeti se Vilson Nikolla është dëshmitar i sigurtë.

Trupi Gjykses gjeti se në çdo aspekt relevant material, dëshmitë e Luz Allakajt, Gjon Nikollës dhe Vilson Nikollës ishin konsistente.

Gjatë dhënies së dëshmisë më 21 tetor 2005, duke përshkruar ngjarjet pas të shtënave, Pren Hili tha se i pandehuri, Anton Nokaj dhe Simon Nokaj ishin në veturën Opel Vectra derisa kjo kaloi pranë dyqanit. Kur dëshmoi gjatë gjykimit të parë të të pandehurit, tha se pamjen e veturës e pengonte një kontenier mbeturinash.

Dëshmia e mëparshme e Mikel Berishës u pranua si provë në pajtim me Nenin 368, KPPK në pajtim me urdhrin e gjykatës më datën 30 shtator 2010, por gjykata nuk është bazuar në të gjatë sjelljes së akt-gjykimit. Deklaratat e mëparshme të Mikel Berishës ishin jashtëzakonisht të dëshme për mbrojtjen, e cila asnjëherë nuk kishte mundësinë për të sfiduar këtë provë gjatë marrjes në pyetje.

Mhill Berisha më parë dëshmoi¹⁷ se doli nga vetura Opel Vectra duke shtënë me Kalashnikov në ajr. Kur dëshmoi para kësaj gjykate më 7 shtator 2010, ai pretendoi se nuk ka parë gjë atë ditë.

Në kohën e vrasjeve, Gjin Preqi njihej edhe me të pandehurin edhe me familjen Allakaj. Ai dëshmoi lidhur me bisedën telefonike me të pandehurin menjëherë pas të shtënave. Fakti se kjo bisedë telefonike është zhvilluar mbështetet nga të dhënat e telefonit. Ai dëshmoi se i pandehuri kishte deklaruar "ne i vramë Allakajt dhe kemi

¹⁷ 31 mars 2005 dhe 30 dhjetor 2005

marrë gjakun". Trupi Gjykues gjeti se Gjin Preqi është dëshmitar i sigurtë dhe i besueshëm.

Avokati Mbrotjës i të pandehurit propozoi që Trupi Gjykues të hedhë poshtë këtë provë bazuar në faktin se inter alia, vrasësi nuk do të reklamonte krimin e tij. Mirëpo, ky ishte një ekzekutim publik. Është e qartë se kryerësit nuk merakoseshin për mundësinë që mund të zbuloheshin. Në fakt, dukej se sa më publike që të jetë, aq më i mirë ekzekutimi do të ishte. Ishte çështje e nderit të familjes në kontekst të gjakmarrjes.

Dëshmia e Luz Allakaj, Gjon Nikollës dhe Vilson Nikollës lidhur me atë se çfarë sipas tyre ka thënë Tune Allakaj lidhur me identitetin e sulmuesve të tij ishte me të dëgjuar nga të tjerët. Neni 157 (1), KPPK lexon Gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një dëshmi ose duke i dhënë rëndësi vendimtare një dëshmie a një prove tjetër e cila nuk mund të kundërshtohet nga i pandehuri ose mbrojtësi përmes marrjes në pyetje gjatë ndonjë faze të procedurës penale. kjo përfshin edhe të thënat.

Sidoqoftë, të thënat konsiderohen prova të pranueshme. Çështja që ngrit Trupi Gjykues është vlera probative e kësaj prove, në veçanti pesha e saj.

Çështja e parë që duhet përcaktuar nga gjykata është se a i ka shqiptuar vërtetë Tune emrat, të cilët sipas Luz Allakaj, Gjon Nikolla dhe Vilson Nikolla janë thënë nga Tuna.

Luz Allakaj dëshmoi para këtij Trupi Gjykues se e ka pyetur Tunën "Kush e bëri këtë". Tune u përgjigj "Nokaj".

Luz Allakaj dëshmoi se e pyeti Tunen për herë të dytë se kush ishte përgjegjës. Ai tha se Tune u përgjigj "Nokaj. Danil, Anton, Simon, Leonard dhe Rrok Bezhi" kjo ishte në përputhje me dëshminë që ka dhënë para gjykatësit hetues në prill të vitit 2004.

Mirëpo, gjatë dëshmisë në gjykimin e parë të të pandehurit, Luz Allakaj tha se në përgjigje ndaj pyetjes së tij, Tune u përgjigj "Danil Nokaj, Anton Nokaj, Rrok Bezhi, Leonard Nokaj dhe Simon Nokaj". Pra, kur Kryetari i Trupit Gjykues kërkoi sqarim të saktë të asaj që ka thënë Tuna, Luz Allakaj dëshmoi "[Tune]...përmendi emrat dhe mbiemrat". Kjo

dëshmi ishte në përputhje me dëshminë e dhënë më 31 korrik 2008.

Gjon Nikolla dëshmoi se Luz Allakaj pyeti Tunen "kush ishte, vëlla?" dhe Tuna u përgjigj "Nokajt".

Gjon Nikolla dëshmoi se pasi që u vendos Tuna në pjesën e pasme të veturës Mercedes, Luz Allakaj sërish e pyeti Tunen se kush ishte përgjegjës. Tuna u përgjigj "Antoni, Danili, Rroki, Simoni dhe Leonardi". Kjo përputhet me deklaratën e tij të dhënë më 26 prill 2004, deklaratën e tij të dhënë më 3 mars 2005, deklaratën e tij të dhënë më 25 nëntor 2005 dhe deklaratën e tij të dhënë më 5 maj 2009.

Një çështje tjetër u ngrit lidhur me saktësinë e fjalëve e të para që Tuna i tha të vëllait. Mbase Luz Allakaj e ka pyetur "vëlla, a je gjallë?". Pjesa relevante dhe materiale e këtij shkëmbimi ka të bëjë me atë që ka thënë Tuna lidhur me identitetin e sulmuesve të tij.

Luz Allakaj dëshmoi se Tuna poashtu deklaroi se i pandehuri ishte ai "përpara". Kur u pyet se pse nuk e ka përmendur këtë fakt më parë pasi që e përmendi një herë në një deklaratë të dhënë më 14 prill 2004 por jo edhe në deklaratat e tjera, ai tha se thjeshtë nuk është pyetur.

Gjon Nikolla dëshmoi se i kishte dëgjuar emrat *qartë*. Kjo përputhet me deklaratën që i ka dhënë gjykatësit hetues më 26 prill 2004.

Në deklaratat e tij të 31 korrik 2008, Gjon Nikolla tha se e ka dëgjuar Tunen duke thënë "Danil Nokaj, Rrok Bezhi, Simon Nokaj, Anton Nokaj dhe Leonard Nokaj".

Vilson Nikolla dëshmoi se gjatë udhëtimit për në spital Tuna kishte përsëritur dy apo tre herë emrat e personave që ka thënë se kanë shtënë në drejtim të veturës, duke e goditur atë dhe Dede Allakaj. Ai tha se kishte qenë Danili, Simoni, Antoni dhe Rrok Bezhi. Në deklaratën e tij të dhënë më 25 shkurt 2005, ai tha se Tune përmendi Danilin, Simonin, Antonin, Rrok Bezhin dhe Leonardin. Kur dëshmoi para Trupit Gjykses, atij nuk i kujtohej Tune Allakaj të ketë përmendur Leonard Nokaj.

Dëshmitarët nuk janë gjithnjë konsistentë lidhur me gjuhën e saktë që ka përdorur Tune secilën herë që është kërkuar nga ai që të identifikojë sulmuesit e tij. Mirëpo,

përgjatë dëshmimeve të tyre ekziston një linjë e përbashkët. Dëshmitarët janë të qartë se Tuna përmendi "Nokaj" dhe "Danil". Trupi Gjykses gjeti se Tuna Allakaj përmendi të pandehurin si njëri ndër sulmuesit e tij.

Duke pasur parasysh bindjen se Tuna përmendi të pandehurin si njëri ndër personat përgjegjës për vrasjen e tij dhe atë të të vëllait, Trupi Gjykses duhet të shqyrtojë peshën që do t'i falë kësaj prove.

Gjatë përcaktimit të peshës probative të kësaj prove, Trupi Gjykses përdori testin pesë-fazësh si në vijim:

- i. A mund të përjashtohet mundësia e përzierjes apo shtrembërimit?
- ii. Për t'u përgjigjur në këtë pyetje, Trupi Gjykses duhet të bindet se incidenti ka qenë kaq i pazakonshëm, tronditës apo dramatik sa që ka dominuar mendimet e viktimës duke shkaktuar kështu një reagim instinktiv pa lejuar mundësinë për reflektim të arsyeshëm, në rrethana të përafërta nëse jo në të njëjtën kohë me ngjarjen;
- iii. Për të qenë mjaft spontan, deklarata duhet të jetë e lidhur ngusht me incidentin shkaktar;
- iv. Nuk duhet të ketë tipare të veçanta që lejojnë hapësirë për përzierje apo shtrembërim;
- v. Nuk duhet të ketë tipare të veçanta që mund të rezultojnë në gabim për shembull dehje.

Luz Allakaj, Gjon Nikolla dhe Vilson Nikolla dëshmuan se Tuna Allakaj ka përmendur, inter alia, të pandehurin si njërin prej sulmuesve të tij. Ai ka përmendur emrin e të pandehurit në vend-ngjarje brenda pesë minutave pas të shtënave dhe shkurt pas kësaj, gjatë udhëtimit për në spitalin e Gjakovës. Ai një gjë të tillë e ka bërë pa iu nënshtruar ndonjë intervenimi mjekësor që ka mund të zvogëlojë mundësinë e të tij për të arsyetuar apo për të përshkruar në mënyrë koherente rrjedhën e ngjarjeve. Tuna ka pësuar lëndime të rënda. Ç'është e vërteta, këto lëndime ishin vdekjeprurëse. Ai ndoshta edhe e ka ndjerë se do të vdiste. Sapo kishte parë vrasjen brutale të

vëllait. Ai kishte pësuar lëndime në fytyrë dhe gjuhë. Kishte gjak në gojë. Kishte vështirësi në të folur. Por prapëprap, ia doli të artikulonte fjalët.

Duke pasur parasysh këto tipare, Trupi Gjykues gjeti se deklaratat e bëra nga Tune Allakaj u bënë mjaft spontanisht lidhur me incidentin në fjalë dhe në rrethana nën të cilat ai ishte aq emocionalisht i rënduar nga ndodhia sa që mundësia që të gënjejë mund të përjashtohet.

Mhill Berisha ishte më pak i sigurtë gjatë dëshmisë së tij. Dëshmia e tij nuk paraqiste përpjekje për të ndihmuar të pandehurin. Ai vetëm pretendoi injorance lidhur me ngjarjet që u zhvilluan ditën në fjalë. Ai u përpoq të distancohej nga dëshmia që ka dhënë në prokurori më 30 dhjetor 2005 dhe më parë më 31 mars 2005 ku në mënyrë të sigurtë ai ka përshkruar rrjedhën e ngjarjeve në esencë konsistente me dëshminë e dëshmitarëve të tjerë. Shihet qartë se ai hezitonte të implikohej në konflikt që kishte prishur harmoninë në komunitetin e tij. Trupi Gjykues nuk e pranoi dëshminë që Mhill Berisha ka dhënë para këtij Trupi Gjykues duke thënë se nuk ka parë gjë. Kjo dëshmi kundërshtoi dëshminë e tij të mëparshme në atë masë sa që ishte e pamundshme të vazhdohet. Pra, Trupi Gjykues ka vendosur të pranojë dëshminë që ka dhënë Mhill Berisha më 31 mars 2005 dhe pas kësaj atë prokurorit më 30 dhjetor 2005.

Deklaratat apo dëshmitë e mëparshme të Anton Nikollës, Zef Delijajt, Robert Delijajt, Pren Hilit, Biter Prekajt, Anton Markut, Mentor Bytyqit, Gjok Komanit, Prene Nokajt, Trashe Nokajt dhe Alfred Nokajt janë pranuar.

Anton Nikolla përshkroi të ketë parë një veturë Opel Vectra duke i kapuar pranë pasi që ka dëgjuar të shtënat. Ai tha se ka njohur Anton Nokaj dhe Rrok Bezhin brenda në veturë. Ai nuk ka njohur vozitësin apo personin e katërt në veturë. Ai tha se ishte rreth 5 metra larg nga vetura që po lëvizte rreth 50kph. Në gjykimin e parë të të pandehurit, ai ka thënë se nuk ka njohur të pandehurin si vozitësin e veturës Vectra.

Vilson Nikolla voziti Tune Allakaj deri në spitalin e Gjakovës. Ai ishte i shoqëruar nga Anton Nikolla. Ai përshkroi një bisedë në mes të Tune Allakaj dhe Vilson Nikollës gjatë udhëtimit për në spital. Ai dëshmoi se Tuna

kishte dashur të thotë diçka. Vilsoni e ndali atë. Ai tha se e dëgjoi Tunen duke përmendur emrin Rrok.

Mentor Bytyqi përshkroi biseda të shkurtëra me Tune Allakajn pas arritjes në spital. Tune shprehej qartë dhe ishte i aftë të komunikonte edhe pse me vështirësi. Ai përshkroi Luz Allakaj të ketë folur shkurt me Tune.

Gjok Komani tha se Tuna e kishte vështirë Tune Allakaj të artikulonte fjalët, por që ai mund ta kuptonte. Gjok Komani nuk ishte mjeku përgjegjës. Që të dy Mentor Bytyqi dhe Gjok Komani më parë kishin dëshmuar se Tuna ishte i aftë të komunikonte edhe pse me vështirësi në rritje e sipër për shkak të lëndimeve dhe më vonë, intervenimit mjekësor.

Prene Nokaj dhe Trashe Nokaj janë nëna dhe tezja/halla e të pandehurit. Sipas dëshmisë së tyre, i pandehuri ishte në shtëpi në kohën e vrasjeve. Kjo dëshmi është kundërshtuar në mënyrë direkte nga dëshmitarët e tjerë.

Vilson Nikolla dëshmoi të ketë parë të pandehurin në shtëpinë e Rrok Bezhit para vrasjeve. Ai dëshmoi se i pandehuri ishte një ndër personat që kishte parë duke vrapuar nga drejtimi i urës drejt veturës Opel Vectra menjëherë pas të shtënave. Ai tha se i pandehuri po mbante një armë. Vilson Nikolla dëshmoi se i pandehuri po voziste veturën Opel Vectra kur kaloi pranë dyqanit të Zef Delisë. Pren Hili dëshmoi më 21 tetor 2005 se veturën po e voziste i pandehuri. Anton Nikolla dëshmoi se Anton Nokaj dhe Rrok Bezhi ishin në veturë kur ju kaloi ajo pranë. Ai nuk ia doli të njohë vozitësin. Mhill Berisha pa të pandehurin duke zbritur nga vetura Opel Vectra dhe duke shtënë me armë në ajr. Gjini Preqi dëshmoi lidhur me bisedën e tij telefonike me të pandehurin në 10.41 ku i pandehuri ka deklaruar "i kemi vrasur Allakajt dhe kemi marrë gjak". Luz Allakaj, Vilson Nikolla dhe Gjon Nikolla dëgjuan Tune Allakajn duke thënë emrin e të pandehurit si njëri ndër sulmuesit e tij. Trupi Gjykues gjeti se dëshmitë paraprake të Prene Nokaj dhe Trashe Nokaj ishin në çdo aspekt material të rreme dhe të krijuara për ndihmuara të pandehurin.

Alfred Nokaj dëshmoi se në ditën kritike ai po punonte në arë kur erdhi i pandehuri dhe i tha se duhet të shkojnë në shtëpi sepse Anton Nokaj kishte marrë hak. Ai tha se atë ditë nuk kishte dëgjuar të shtëna. Ai nuk e dinte se sa

kishte qenë ora kur kishte biseduar me të pandehurin, por mendoi se ishte para orës 11. Ai nuk solli alibi për të pandehurin. Atij nuk i kujtohej sa kishte qenë ora kur kishte folur me të pandehurin. Thelbi i dëshmisë së tij ishte fakti se i pandehuri kishte deklaruar se Anton Nokaj kishte marrë hak. Kjo dëshmi ishte me të thëna. Alfred Nokaj nuk ka dhënë dëshmi direkte në mbrojtje të të pandehurit. Sidoqoftë, duke pasur parasysh të gjeturat faktike të Trupit Gjykues ku edhe po referohemi tani, Trupi Gjykues është i mendimit që ka pak gjasa që i pandehuri vërtetë i ka thënë Alfred Nokaj se Anton Nokaj dhe vetëm Anton Nokaj kishte marrë hak.

Zef Delija dëshmoi më 6 prill 2005 në gjykimin e Anton Nokaj. Me të dëgjuar të shtëna armësh, ai përkroi të ketë parë një veturë duke iu afruar dyqanit. Ai tha se nuk ka mundur të shohë se kush ka qenë brenda në veturë për shkak se pamjen i kishte penguar një kontenier mbeturinash.

Robert Delija dëshmoi më 5 prill 2005 në gjykimin e Anton Nokaj. Pas të shtënave, pa një veturë Opel Vectra që po voziste me shpejtësi të lartë. As ai nuk ka mundur të shohë se kush ishte brenda në veturë për shkak të një kontenieri të madh që po i pengonte pamjen.

Pren Hili dëshmoi më 27 prill 2004 se pasi që dëgjoi të shtënat, ai pa një veturë me ngjyrë të kaltër të mbyllur Opel Vectra duke kaluar rreth 3 metra nga vendi ku ai po qëndronte. Ai tha se e ka parë vozitësin, por nuk e ka njohur. Ai nuk ka parë se a kishte pasagjerë të tjerë në veturë.

Kur dëshmoi më 13 prill 2005 në gjykimin e Anton Nokaj, ai përkroi të ketë dëgjuar të shtëna dhe pastaj të ketë parë veturën me ngjyrë të kaltër të mbyllur Opel Vectra të Anton Nokajt duke i kaluar pranë.

Me rastin e marrjes në pyetje më 21 tetor 2005, Pren Hili deklaroi se në ditën kritike në veturën Opel Vectra ishin Anton Nokaj, Danil Nokaj dhe Simon Nokaj. Ai deklaroi se këtë nuk e ka thënë më parë nga frika nga familja Nokaj.

Gjatë dhënies së dëshmisë më 13 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit, ai ka thënë se nuk ka parë se kush ishte në veturë ngase pamjen e veturës i pengonte kontenieri i mbeturinave jashtë dyqanit.

Anton Marku dëshmoi më 17 mars 2005 në gjykimin e Anton Nokaj. Ai përshkroi të ketë dëgjuar të shtëna arme dhe pastaj të ketë parë veturën Opel Vectra që i përket Anton Nokajt duke vozitur në drejtim të dyqanit. Ai dëshmoi se ishin 5 persona në veturë. Ai tha se nuk njohu asnjërin prej tyre.

Sikurse Mhill Berisha, Zef Delija, Robert Delija, Pren Hili, dhe Anton Marku ishin më pak se të sigurtë në dëshmitë e tyre. Edhe ata pretendonin injorancë sa u përket ngjarjeve të ditës kritike. Me të vizituar *locus in quo* dhe me të qëndruar jashtë dyqanit të Zef Delijajt, Trupi Gjykses nuk mund të besojë dot se një kontenier mbeturinash mund të pengojë pamjen e dëshmitarëve të rrugës apo të parandalojë që këta të vërejnë veturën Opel Vectra duke u afruar dhe pasagjerët brenda në të. Ata gënjen kur thanë se nuk kanë mundur të shohin pasagjerët brenda në veturë.

Biter Prekaj në deklaratën e datës 8 gusht 2008 ka deklaruar se Rrok Bezhi i kishte thënë atij se i pandehuri, Anton Nokaj, Simon Nokaj dhe Leonard Nokaj ishin përgjegjës për vrasjen e Tune dhe Dede Allakaj.

Kur dëshmoi më 18 maj 2009 në gjykimin e parë të të pandehurit, ai mohoi që Rrok Bezhi të ketë përmendur të pandehurin.

Sikurse ishte rasti me shumë dëshmitarë të tjerë në këtë rast, Biter Prekaj ndryshoi dëshminë e tij. Sidoqoftë, dëshmia e këtij dëshmitari lidhur me atë se çfarë thotë ky se ka thënë Rrok Bezhi është me të dëgjuar.

Gjatë inspektimit të vend-ngjarjes, policia gjeti 19 gëzhoja dhe dy fishekë në vend-ngjarje (kalibri ishte 7.62 x 39). Gëzhojat janë gjetur afër veturës, njëra prej tyre menjëherë në pjesën e përparme të veturës dhe të tjerat në distanca të ndryshme në rrugë apo në pjesën e djathtë të veturës prapa veturës.

Totali prej 24 vrime plumbash janë gjetur në shasi të veturës Mercedes. Pesë vrime plumbash janë vërejtur në xhamin e përparëm, gjashtë vrime plumbash në xhamin e pasëm; që të katër dritaret anësore ishin të thyera dhe në ulëse kishte shpime dhe gërvishtje, në kapakun e mbulojës së motorrit gjendej një vrimë plumbi, shkaktuar nga një armë që ka shtënë nga pjesa e përparme, një vrimë plumbi në

anën e djathtë mes gomës përpara dhe derës prapa, shtënë nga një kënd i pjerrët nga lart poshtë, një vrimë plumbi në pasqyrë, shkaktuar nga një e shtënë me armë nga pjesa e përparme e veturës, dy vrima plumbash në derën e përparme në anën e djathtë, shkaktuar nga një e armë që ka shtënë nga ana e djathtë, pesë vrima plumbash në derën e pasme në anën e djathtë, shkaktuar nga të shtëna armësh nga ana e djathtë, nga pas përpara, një vrimë plumbi afër kapakut të serbatorit/rezervuarit shkaktuar nga një armë që ka shtënë nga ana e djathtë, një vrimë plumbi në anën e pasme të veturës.

Dede dhe Tune Allakaj u gjenden brenda në veturë. Nuk ka ndonjë provë që tregon se Tuna ose Dede Allakaj ishin në posedim të armës në kohën në fjalë. Asnjë nuk është gjetur në vend-ngjarje. Trupi Gjykues nuk mund të pranojë mendimin e mbrojtjes se disa nga gëzhojat e gjetura në vend-ngjarje mbështetin versionin se të ndjerit ishin të armatosur dhe apo se Anton Nokaj po vepronte i vetëm.

Përpos një gëzhoje të gjetur në pjesën e përparme nën veturë, të tjerat janë gjetur prapa veturës në distancë prej 6 deri në 28 metra. Logjikisht, kjo sugjeron se vetura po lëvizte me shpejtësi të vogël përpara kur është shtënë.

Qlirim Hajdini kreu krahasimin mikroskopik të 35 gëzhojave të 7.62 x 39mm kalibri dhe një gëzhojë 7.62 x 39mm, të papërdorur, të gjetur në vend-ngjarje.

Në raportin e tij të datës 14 maj 2004¹⁸, që u qartësua nga dëshmia e tij e dhënë më 13 maj 2009 gjatë gjykimit të parë të të pandehurit, ai deklaroi se nga 35 gëzhojat, 24 janë shtënë nga e njëjta armë. Nga gëzhojat e mbetura, 9 dhe gëzhoja e papërdorur janë shtënë nga një armë e dytë. Dy gëzhojat e mbetura janë shtënë nga një armë e tretë.

Dy nga gëzhojat janë shtënë nga e njëjta armë dhe tre prej tyre nuk kishin karakteristika të mjaftueshme për analizë të mëtutjeshme.

Në përfundim të raportit të tij, Qlirim Hajdini deklaroi se 35 gëzhojat dhe një e pashpenzuar janë shtënë nga tre armë të ndryshme 7.62 x 39mm. Duke pasur parasysh faktin se të shtënat ishin nga tre armë të ndryshme, është e logjikshme

¹⁸ Dorëzuar me Memorandumin e datës 18 maj 2004

të mendohet se të paktën tre persona ishin të përfshirë në vrasje. Kjo përputhet me provat e vërteta dhe përputhet edhe me dëshminë e Vilson Nikollës, i cili përshkroi se tre persona me armë po vraponin nga vend-ngjarja dhe në drejtim të veturës Opel Vectra. I pandehuri ishte një ndër tre personat e armatosur.

Të gjitha sendet u dorëzuan në Divizionin e Balistikës, rastet e hapura. Nuk kishte ndonjë përputhje.

Te Trupi Gjykses nuk është sjellur asnjë provë që tregon se është bërë ndonjë bastisje e menjëhershme jashtë kopshtit të të pandehurit. Nuk kundërshtohet se gëzhojat janë gjetur jashtë kopshtit të Anton Nokajt. Kjo sigurisht se është relevante për dëshminë e Mhill Berishës, i cili dëshmoi se i pandehuri po voziste veturën Opel Vectra, se ai zbriti nga vetura dhe shtiu në ajr. Sqarimi më i mundshëm për mungesën e provave të tilla është thjeshtë se policia nuk ka bërë bastisje të sipërfaqes jashtë kopshtit të të pandehurit. Siç duket në fazë, hulumtimet e policisë ishin të përqëndruara në Anton Nokajn. Nuk mund të ketë pasur Mhill Berisha motiv për të gënjyer për këtë. A konfuzohej ai kur theksohej fjala 'i pandehuri' dhe fjala 'Anton Nokajt'? Jo. Ai tha e i pandehuri u fut në kopshtin e tij dhe pastaj u largua me veturën e tij BMW.

Arsim Gerxhalliu kreu autopsinë e që të dy Dede Allakaj¹⁹ dhe Tune Allakaj²⁰. Ai dëshmoi më 30 mars 2005 në gjykimin e Anton Nokajt. Ai sërish dëshmoi më 18 maj 2009 gjatë gjykimit të parë të të pandehurit.

Në vijim kemi transkribimin e përkthimit në anglisht të autopsive të kryera të Dede Allakajt dhe Tune Allakaj.

Ded Allakaj pësoi lëndimet si në vijim:

1. Në pjesën e pasme të veshit të djathtë, lëkura ka pësuar plagë sipërfaqësore të madhësisë 95 x 15 mm (1.1), në thellësi deri në 5 mm - nga pjesa e prapme në atë të përparme, duke shpuar pjesën e poshtme të veshit mu në mes - duke vazhduar deri para veshit. Lëkura përreth është pak e hijëzuar - sidomos në fillim të pjesës së prapme.

¹⁹ MA/04-064

²⁰ MA/04-065

2. Në pjesën e pasme të majtë (okspitale) të kokës, 3 cm nën linjën e epërme horizontale dhe 2 cm nga mesi i linjës së prapme anatomike vërehet një lëndim lëkure në formë të yllit me madhësi 30 x 18 mm, me kënde të çrregullta dhe të kthyer pak brenda - me gjak - dhe duke krijuar një vrimë hyrëse (2.2) - ku futet plumbi në kokë duke sulmues pjesën e përparme të kafkës (pas hapjes së vrimës është e madhësisë 8 x 7 mm në shenjë koni të futur brenda në kafkë 15 x 12 cm) - duke shkaktuar kështu frakturë në kafkë (drejtë pjesës së përparme) - duket se ka shkatërrim të pjesës së përparme në shumë pjesë - pastaj lëndim të trurit - pjesës së butë dhe të fortë trurore (laserim) - pjesa e epërme e hemisferës së majtë të trurit - pastaj dëmton pjesën e përparme (në masë të madhe) dhe fraktura është e ndërlidhur me fraktura të tjera - gjendet plumbi në pjesën e majtë të ashtit të përparëm, 3 cm nga linja e mesme anatomike (pas hapjes vrima e madhësisë 9 x 9 mm me kon të drejtuar jashtë - 14 x 12 mm) - duke treguar kështu një lëndim të përbërë nga vrima dalëse (2.2) - të formës së çrregullt qarkore me madhësi 13 x 9 mm - me kënde të formës pothuajse të rregullt dhe të kthyer jashtë dhe të mbuluara me gjak. Trajektorja e plumbit nga prapa përpara dhe lehtëzi nga e djathta në të majtë.
3. Në pjesën e prapme të poshtë të oksipitalit të majtë, 5.5 cm nën lëndimin e përshkruar nën 1.1 - shihet një lëndim i lëkurës në formë të rregullt - të yllit të madhësisë 27 x 18 cm (3 cm nga linja e mesme e prapme anatomike - dhe 8.0 cm nën linja e epërme horizontale) - këndet janë të çrregullta dhe të penguar - të mbuluara me gjak - të njëjtat përbëjnë vrimën hyrëse (3.1) - ku plumbi hyri në kokë duke sulmuar ashtin e kafkës (pas hapjes së ashtit të kafkës - me madhësi 9 x 8 mm me zgjërime të konit me drejtim brenda 13 x 13 mm) duke shkaktuar kështu frakturë të kafkës që ndërlidhet me fraktura të tjera - dhe pastaj lëndime, pjesa e fortë dhe e butë e trurit (laserim) - pjesa e poshtme e hemisferës së majtë (në këtë pjesë vërehet një gjakderdhje përgjatë bazës së hemisferës së majtë) - pastaj orbita e syrit dhe ashti zeugmatik (gjatë këtij rrugëtimi është lënduar syri i majtë) - dhe pastaj plumbi ka dalur jashtë- 13 mm poshtë dhe jashtë nga këndi i jashtëm i syrit të majtë duke përbërë kështu vrimën dalëse (3.2), (10 cm nën linjën e epërme horizontale) i formës qarkore me kënde të

rregullta, të shqyera jashtë dhe të mbuluara me gjak, me dimensione prej 15 x 10 mm. Trajektorja e plumbit nga prapa përpara, lart poshtë dhe nga djathtë lehtëzi në të majtë.

4. Në pjesën e jashtme të prapme të qafës, në anën e majtë, me madhësinë prej 48 x 39 mm vërehet një lëndim i formës së çrregullt qarkore - me urë ndërlidhëse prej indeve lëkurore në anën e përparme, me kënde të kthyer nga brenda - sidomos vendi ku hyri plumbi është i shënjuar mjaft - hyrja e njëjtë përputhet me pikën hyrëse (4.1); pas hyrjes së plumbit, trajektorja sulmoi muskujt periferikë (copëza e metaltë e gëzhojës gjendet në këtë pjesë), enët e gjakut (pjesa e majtë e shkatërruar në vazhdimësi), ana e majtë e ashtit hioid është e thyer, pjesa e epërme e trakesë është e dëmtuar në anën e majtë të prapme, hapja e trakesë tregon plumbin (e gëlltitur) në fund të saj, 1.5 cm nga ndarja në dy pjesë, në anën e majtë. Foto RTG 1. (Plumbi dhe gëzhoja të dërgohen në polici për ekzaminim të mëtutjeshëm balistik). Trajektorja e plumbit nga prapa përpara.
5. Në kuadrantin e majtë të epërm të shpinës, 3 cm nga pika e mesme anatomike dhe 11.5 cm më poshtë nga ana e poshtme e qafës, ekziston një lëndim lëkuror në formë ovale me kënde lehtë të kthyer brenda e që përbën vrimën hyrëse (5.1), dimensione prej 12 x 7 mm dhe 188 mm thellësi - maja e matësit prekë pjesën ashtërore të skapulës, e cila nuk është e thyer, mirëpo, në këtë rast, gjatë lëvizjes së tij, plumbi ka humbur energjinë derisa ka arritur te trupi i të ndjerit dhe nuk gjendet në vrimë. Lëndimet gjendet në lëkurë, nën indet lëkurore dhe muskulit periferik.
6. Në dorën e djathtë, pjesa e epërme, mu në fund në pjesës së poshtme të dorës, në sipërfaqen e jashtme, ekziston një lëndim në lëkurë (lëndim sipërfaqësor) prej 68 x 20 mm, (6.0) plagë që shtrihet dhe ka formën e çrregullt ovale, me thellësi deri në 6 mm, me matje nga përreth prej 2 mm e sidomos në anën e pasme. Trajektorja nga prapa përpara.
7. Në pjesën e prapme eksteriore të gjurit të djathtë ekziston një lëndim në lëkurë me formë qarkore me kënde që futen brenda, dimensionet prej 9 x 8 mm, e që përbën vrimën hyrëse (7.1) dhe vazhdon përgjatë këmbës

duke dëmtuar lëkurën, indet nën-lëkurore dhe muskujt periferikë dhe pastaj vazhdon në pjesën e prapme të sipërfaqes së brendshme të këmbës së djathtë - e që përbën vrimën dalëse (7.2) - dimensionet prej 15 x 11 mm, me kënde dalëse në formë paksa ovale. Trajektorja nga e djathta në të majtë, nga prapa përpara.

8. Në sipërfaqen e brendshme nën gjurin e djathtë (1/3 të pjesës së epërme) ekziston një lëndim në lëkurë 42 x 22 mm, thellësia 3 mm, i formës së çregullt ovale, me një rreth me ngjyrë të mbyllur në pjesën e prapme (8.1). Është dëmtuar lëkura si si dhe indet nën-lëkurore dhe është një lëndim sipërfaqësor dhe tangjential. Trajektorja (bazuar në lëndimet dhe në rrobat) shtrihet nga prapa përpara dhe nga e djathta në të majtë.

Në përmbledhjen e tij, patologu përfundoi se lëndimet e përshkruara nën pikët 2, 3 dhe 7 janë plagë tejkuese; lëndimet e përshkruara nën pikët 4 dhe 5 janë hyrëse ndërsa lëndimet e përshkruara nën pikët 1, 6 dhe 8 janë lëndime sipërfaqësore tangjenciale. Sipas mendimit të tij, lëndimet e pësuar me anë të armës së zjarrit janë konsistente me pozicionin e tij prej të ulurit në çastin e marrjes së tyre. Dede Allakaj vdiq si pasojë e shqyerjes e organeve vitale p.sh. trurit, trakesë dhe enëve të gjakut në qafë për shkak të lëndimeve tejkuese që shkaktuan gjakderdhje konsistente me plagë të marra nga arma e zjarrit.

Tune Allakaj pësoi lëndimet si në vijim:

1. Në anën e djathtë të fytyrës, mu mbi mollëzën e djathtë në distancë prej 3 cm nga këndi i jashtëm i syrit të djathtë dhe në distancë prej 4,5 cm nga ekstremiteti i anës së majtë të hundës, vërehet një lëndim i çregullt në lëkurë (1.1) në formë të yllit me madhësi 20 x 15 mm, që karakterizohet me kënde të çregullta dhe të kthyer pak brenda - pa rreth të rrumbullak - drejt pjesës së saj të epërme, ekziston një mavijosje e lehtë me ngjyrë të errët me gjërësi deri 1 mm dhe përputhet me plagën hyrëse. Plumbi hyri në trupin e të ndjerit duke shkaktuar lëndim në lëkurën e fytyrës, pastaj në pjesën dermale dhe në ashtin e mollëzës së djathtë (i njëjti ka pësuar frakturë radiale drejt dhëmbëve të anës së djathtë të nofullës së epërme) dhe trajektorja vë në pah dëmtimin

e pjesës së djathtë të gjuhës, pastaj anën e majtë të qafës, (përfshirë këtu dhe muskujt periferikë dhe arterien e majtë karotide) pastaj indet dermale - dhe gjatë daljes, ka shkatërruar indet epidermale të anës së majtë të qafës (në sipërfaqen e jashtme) saktësisht 8 cm nën këndin e poshtëm të pjesës së poshtme të veshit të djathtë dhe 1 cm para mesit të linjës së prapme anatomike (1.2) me madhësi 10 x 06 mm, me formë të çrregullt ovale me kënde të jashtme. Përputhet me plagën dalëse. Në RTG, vërehen copëza të vogla metalike (gëzhojat e plumbit) në anën e poshtme të qafës dhe në nofullën e majtë). Trajektorja dhe anatomia (kanali) i plumbit nga prapa përpara, nga lart poshtë dhe nga e djathta në të majtë.

2. 18 mm nën lëndimin e përshkruar nën pikën 1 (1.1) dhe në distancë prej 28 mm nga këndi i poshtëm i pjesës së poshtme të veshit, vërehet një lëndim në lëkurë me madhësi prej 40 x 20 mm (të formës së çrregullt ovale dhe kënde të çrregullta të kthyer nga brenda dhe të mbuluara me gjak, me mavijosje të lehtë 1 mm në pjesën e epërme dhe përputhet me plagën hyrëse. Plumbi hyri në trupin e të ndjerit duke shkaktuar kështu lëndim në lëkurë, inde dermale në anën e djathtë të fytyrës, muskujve periferikë dhe me thellësi 18 mm, saktësisht në anën e djathtë në nofullës së poshtme të djathtë, plumbi u gjet i ngjitur në asht duke shkaktuar kështu frakturë të këtij të fundit. Drejtimi nga e djathta në të majtë dhe poshtë.
3. 23 mm nën dhe lehtëzi të kthyer brenda plagës së përshkruar nën pikën 2 në pjesën e epërme të anës së djathtë të qafës, gjendet një lëndim në lëkurë me madhësi 30 x 15 mm dhe thellësi 5 mm, në formë ovale me kënd të rregullt nga ana e poshtme me dëmtim të indeve dermale dhe epidermale duke përfshirë edhe pjesën sipërfaqësore të muskujve periferikë - lëndimi vazhdon me drejtim poshtë dhe zgjerohet drejt anës së majtë duke shkaktuar lëndime të vogla epidermale dhe duke përfunduar me lëndim lëkuror sipërfaqësor në anën e djathtë të epërme të kafazit të kraharorit duke u lidhur me pjesën e poshtme të qafës. Plaga është sipërfaqësore dhe tangjenciale dhe nuk përjashton mundësinë që të jetë shkaktuar nga elementi periferik gjatë trajektores së plumbit. Drejtimi është nga e djathta në të majtë, nga lart poshtë dhe nga prapa lehtëzi përpara.

4. Në kuadrantin e djathtë të epërm të gjoksit - në anën e djathtë ku fillon pjesa e brendshme e anës së majtë të gjoksit, ekzistojnë disa lëndime sipërfaqësore në lëkurë (që përfshin vetëm epidermën) me madhësi të ndryshme, nga 2 x 1 deri në 11 x 10 mm, dhe pothuajse që të gjitha karakterizohen me rreth me ngjyrë të errët shtypjeje përreth lëndimeve.
5. Në 1/3 e pjesës së epërme të sipërfaqes së jashtme të paralelit të majtë ekziston një lëndim tangjential që shkaktoi lëndimin e indeve epidermale dhe atyre dermale, të muskujve periferikë dhe ligamenteve të tyre, me madhësi 9 x 4, 5 cm dhe me thellësi 2 cm, me kënde të çrregullta dhe të formës së çrregullt ovale, me mavijosje shtypjeje me ngjyrë të errët përreth nga ana e brendshme. Drejtimi nga para prapa (duke qenë i mendimit se dora ishte në timon).
6. Në sipërfaqen e brendshme të paralelit të djathtë vërehet një mavijosje me ngjyrë kafe dhe kaltër në madhësi prej 60 x 25 mm.

Patologu përfundoi duke deklaruar se plaga vdekjeprurëse ishte lëndimi i përshkruar më lart nën pikën 1.

Nuk vërehen shenja të lëndimeve të tjera traumatike përpos përshkrimeve të lartpërmendura të ekzaminimit të jashtëm dhe të brendshëm.

Ndryshimet post mortem të vërejtura gjatë ekzaminimit të Tunës përputhen me kohën e vdekjes dhe me të dhënat në raportin e policisë të nxjerrura nga njësia e forenzikës.

Pas procedurës së plotë të autopsisë dhe informatave nga policia, patologu arriti në përfundimin se Tune Allakaj vdiq si pasojë e ndërprerjes së arteries së majtë karotide nga shqyerja tejshkuese e saj nga veprimi i shpjetësisë së lart të plumbit, gjë që përfundimisht shkaktoi shok hemoragjik.

Trupi Gjykues është i mendimit se lëndimet e pësuar nga Dede Allakaj dhe Tune Allakaj janë konsistente me një numër të shtënash nga arma e zjarrit.

Duke marrë në konsideratë inter alia Raportin e vendngjarjes së Njesisë Forenzike të Gjakovës të datës 24 mars

2004, fotografi të veturës Opel Vectra me targa të regjistrimit 408-KS-799; Raporti i Ekzaminimit të veturës Mercedes me targa të regjistrimit 119 KS 154 të datës 23 prill 2004; fotografitë e targave të regjistrimit të veturës Mercedes 119 KS 154; Raporti i vend-ngjarjes me datën 19 mars 2004; Raporti i Balistikës me datën 18 maj 2004 i Qlirim Hajdinit; Raporti i Autopsisë me numër MA 04/065 i datës qershor 2004 nga Asim Gerxhaliu ; Raporti i Autopsisë (Dede Allakaj) numër MA 04/064 i datës maj 2004 nga Asim Gerxhaliu, dëshmitarët që dëshmuuan para këtij Trupi Gjykses si dhe dëshmitë dhe deklaratat e mëparshme të dëshmitarëve, Trupi Gjykses gjeti se më 19 mars 2004 rreth orës 10.30 në Uren e Jakes në fshatin Marmulle, komuna e Gjakovës, i pandehuri si bashkëkryerës qëllimisht dhe brutalisht dhe në kontekst të gjakmarrjes, i armatosur me armën automatike 7.62mm i zuri pritën të ndjerëve Dede Allakaj dhe Tune Allakaj, të cilët po udhëtonin me veturën Mercedes me targa të regjistrimit 119 KS 154, duke shtënë në veturën në fjalë dhe duke u shkaktuar kështu lëndime vdekjeprurëse Dede Allakaj dhe Tune Allakaj.

Numri total prej 24 vrimash të plumbit janë gjetur në shasi të veturës Mercedes. Ishte ky një ekzekutim mjaft publik.

Është shtënë një numër herësh në Dede Allakajn dhe ky pësoi shqyerje të trurit, trakesë dhe enëve të gjakut në qafë. Është shtënë një numër herësh në Tune Allakaj, arteria e tij e majtë karotide është ndarë në dysh dhe ai vdiq si pasojë e shokut hemoragjik. Ishte ky ekzekutimi brutal i Tune dhe Dede Allakaj derisa këta po ndërmerenin aktivitetet e tyre të përditshme, i kryer nga një gjakmarrje. I pandehuri voziti Opel Vectra nga vendi i ngjarjes. Aiu largua nga Kosova disa ditë më vonë.

Dede Allakaj la pas gruan dhe 4 fëmijët. Tune Allakaj la pas gruan dhe 5 fëmijët.

Nuk ka provë se i pandehuri ishte iniciatori apo se roli i tij në vrasjet ishte më i madh se ai i bashkë-kryerësve. Tre armë janë përdorur. Luz Allakaj dëshmoi se Tune Allakaj tha në vend-ngjarje se "Danili ishte përpara". Edhe nëse Tuna i ka shqiptuar këto fjalë, kjo nuk bën gjë më shumë se të mbështesë versionin e prokurorisë se i pandehuri ishte një ndër bashkë-kryerësit.

I pandehuri nuk ka dënime të mëparshme. Ai është babai i 5 fëmijëve. Sigurisht se fatkeqësisht, edhe ata përbëjnë

viktima në këtë lëndë. U takon të gjithëve që kryejnë vepra penale të marrin parasysh pasojat e veprimeve të tyre.

I pandehuri përshkroi gjendjen e tij financiare si "të mesme".

Duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e këtij rasti, ne jemi të bindur se dënimi është i arsyeshëm dhe proporcional.

Për arsyet e cekura, ne sjellim këtë akt-gjykim.

I datuar më 15 tetor 2010.



Gjykatës Malcolm Simmons
Kryetar i Trupit Gjykses

Verginia Micheva-Ruseva
Anëtare e Panelit

Lumturiqe Muhaxheri
Anëtare e Panelit

Robina Struthers
Proces-Mbjatëse

Këshillë Ligjore: Në bazë të nenit 400 të KPPK, një ankesë duhet të paralajmerohet brenda tetë (8) ditësh pas shpalljes së aktgjyqimit.

Në pajtim me Nenin 398(1) të KPPK, personat e autorizuar mund të ushtrojnë ankesë ndaj këtij akt-gjykimi brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas pranimit të kopjes së të njëjtit.